



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 972/6 Prot.

Tiranë, më 04 . 05 .2026

VENDIM

Nr. 09, Datë 04.05 .2026

PËR
MIRATIMIN E KONTRATAVE TIP DHE ANEKSET PËR MIRATIMIN E
FINANCIMIT TË PROJEKTEVE FITUESE TË PROGRAMEVE KOMBËTARE

Në zbatim të ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 109/2024 "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", VKM nr. 464, datë 31.07.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 607, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), me kërkesë të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Bordi i Administrimit të AKKSHI në mbledhjen e datës 04.05.2026,

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratave tip dhe anekset për miratimin e financimit të projekteve fituese të Programeve Kombëtare (dokumentacioni bashkëlidhur këtij vendimi);
2. Përcjelljen pranë Ministrisë së Arsimit për miratim të kontratave tip dhe anekset për miratimin e financimit të projekteve fituese të Programeve Kombëtare;
3. Ngarkohet AKKSHI për zbatimin e këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Znj. Armela Baka, Kryetar

Z. Erjon Uka, Anëtar;

Znj. Mirela Cami, Anëtar;

Znj. Juljana Margariti, Anëtar;

Znj. Anisa Subashi, Anëtar;

Z. Fatbardh Sallaku, Anëtar;

Znj. Ines Muçostepa Anëtar;

KONTRATË

PËR ZBATIMIN E

PROJEKTIT TË

INFRASTRUKTURËS

SË KËRKIMIT

SHKENCOR

KONTRATË |

PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT TË INFRASTRUKTURËS SË KËRKIMIT SHKENCOR
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT | AKKSHI



[Handwritten signatures in blue ink]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KONTRATË
PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT TË INFRASTRUKTURËS SË KËRKIMIT SHKENCOR
PËR VITIN _____**

Nr. Prot. _____,

Tiranë, më _____._____.2026

E lidhur sot, më datë _____._____.2026, ndërmjet palëve kontraktuese si më poshtë:

Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), me adresë Rruga "Naim Frashëri", Nr. 37 Tiranë, në cilësinë e **Financuesit**, përfaqësuar nga Znj/Z. _____, Drejtor i Përgjithshëm, me numër të letërnjoftimit _____.

Dhe

Universitetit _____, liçensuar me Vendimin Nr. _____, datë _____._____._____, të Këshillit të Ministrave, në cilësinë e **Përfituesit**, përfaqësuar nga rektori Znj/Z. _____, me numër të letërnjoftimit _____.

Palët në këtë kontratë bien dakord si më poshtë:

**Neni 1
Baza ligjore**

Kjo kontratë lidhet në bazë të neneve 109 -113 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 464, datë 31.07.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 607, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)", Vendimit nr.75, datë 12.2.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor" të Këshillit të Ministrave, si dhe Vendimit Nr. _____, datë _____._____.2026 "Për miratimin e financimit të projekteve fituese të infrastrukturës së kërkimit shkencor, për vitin 2026", të Bordit të Administrimit të AKKSHI - së.

**Neni 2
Objekti i Kontratës**

Objekti i kësaj Kontrate është financimi nga AKKSHI, në formë granti, për zbatimin e Projektit me titull: "_____ ", paraqitur nga Universiteti _____, në AKKSHI, nën programin e "Infrastrukturës së kërkimit shkencor", me drejtues projekti Znj/Z. _____.

**Neni 3
Periudha e zbatimit**

KONTRATË |

2



1. Kjo Kontratë hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të saj nga palët dhe përfundon me dorëzimin e raportit përfundimtar nga Përfituesi dhe pranimin e këtij raporti nga Financuesi (AKKSHI). Rezultatet konsiderohen të përmbushura vetëm pas verifikimit dhe miratimit formal nga AKKSHI.
2. Zbatimi i kontratës fillon nga data e kalimit të fondit të projektit sipas buxhetit dhe planit të financimit të miratuar me Vendim Nr. _____, datë _____.____.2026 "Për miratimin e financimit të projekteve fituese të infrastrukturës së kërkimit shkencor, për vitin 2026", të Bordit të Administrimit të AKKSHI - së, në llogarinë e Përfituesit.

Neni 4

Shuma dhe mënyra e Financimit të Projektit

Bazuar në Vendimit Nr. _____, datë _____.____.2026 "Për miratimin e financimit të projekteve fituese të infrastrukturës së kërkimit shkencor, për vitin 2026", të Bordit të Administrimit të AKKSHI - së, AKKSHI-ja do të mbështesë financiarisht zbatimin e projektit me shumën totale prej _____ (me fjalë) lekë.

Me lidhjen e kësaj kontrate, kjo shumë do të kalojë në llogarinë përfituesit duke specifikuar emërtimin e projektit.

Neni 5

Detyrimet e përfituesit

Përfituesi i grantit të financimit të projektit ka detyrimin që:

1. Të zbatojë projektin në përputhje me buxhetin e miratuar dhe planin financiar të projektit që i bashkëlidhet kësaj kontrate.
2. Buxheti i financuar nga AKKSHI për realizimin e projektit, duhet të realizohet nga përfituesi brenda vitit buxhetor 2026.
3. Të kthejë në buxhetin e shtetit, të gjitha fondet e pashpenzuara brenda 15 ditësh pas përfundimit të projektit, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.
4. Të garantojë funksionimin, mirëmbajtjen dhe përdorimin për qëllime kërkimore të infrastrukturës së financuar për një periudhë jo më pak se 5 (pesë) vite nga data e përfundimit të projektit.
5. Të dorëzojë pranë AKKSHI-së raportet (e ndërmjetme dhe përfundimtare) teknike dhe financiare, shoqëruar me dokumentacionin përkatës ashtu siç është përcaktuar në nenin 6 të kësaj kontrate dhe anekset bashkëlidhur.

Neni 6

Raportimi

1. Gjatë zbatimit të projektit, përfituesi i grantit raporton lidhur me ecurinë e zbatimit të projektit sa herë që kjo i kërkohet nga AKKSHI. Forma e raportimit përcaktohet nga AKKSHI.



2. Në përfundim të zbatimit të projektit, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune, përfituesi i grantit dorëzon në AKKSHI, në 2 (dy) kopje, raportin përfundimtar teknik të realizimit të projektit, shoqëruar me shkresë përcjellëse nga rektori i institucionit të arsimit të lartë përfitues i grantit.
3. Raporti përfundimtar hartohet sipas formatit të AKKSHI dhe duhet të përmbajë:
 - a. Raportin përshkruar sipas formatit të përcaktuar nga AKKSHI dhe përcaktimeve të parashikuara në Udhëzuesin PKKSH të publikuar në faqen zyrtare të AKKSHI;
 - b. Raportin financiar, sipas formatit të përcaktuar nga AKKSHI. Raporti financiar duhet të shoqërohet me kopje të dokumentacionit të plotë të prokurimit dhe të blerjes së infrastrukturës kërkimore - shkencore, me kopje të faturave të shpenzimeve, si dhe foto/video të pajisjeve pjesë të infrastrukturës kërkimore - shkencore. Ky raport duhet të firmoset nga drejtuesi i projektit, financieri, administratori dhe rektori i institucionit të arsimit të lartë përfitues i grantit.
4. Pas dorëzimit të raportit përfundimtar final, AKKSHI kontrollon nëse raporti dhe i gjithë dokumentacioni shoqërues është hartuar sipas kriterëve të kërkuara.
 - a. Në rast se raporti përfundimtar është kryer sipas kërkesave, institucioni përfitues merr konfirmimin nga AKKSHI për përmbylljen me sukses të projektit dhe shlyerjen e të gjitha detyrimeve që ka patur ndaj AKKSHI-së në kuadër të zbatimit të tij;
 - b. Në rast të konstatimit të parregullsive, njoftohet përfituesi i grantit për plotësimin/korrigjimin e dokumentacionit brenda 10 (dhjetë) ditë pune.
 - c. Një përmbledhje e produktit të projektit, e përkthyer në gjuhën angleze do të pregatitet nga Përfituesi dhe të publikohet në web faqen zyrtare të IAL-së dhe AKKSHI-së;
 - d. Një video e rugëtimit, zbatimit dhe përdorimit do të pregatitet nga Përfituesi dhe të publikohet në web faqen zyrtare të IAL-së dhe AKKSHI-së;
5. Në rastin kur institucioni përfitues i grantit shkel detyrimin lidhur me raportimet dhe realizimin e produktit/eve parashikuar në projektin e miratuar, AKKSHI kërkon auditimin e shumës së përfituar, deri në kthimin e tij në buxhetin e shtetit.

Neni 7

Të dhëna bankare të përfituesit:

- a. Emri i përfituesit të grantit: _____
- b. NIPT: _____
- c. Kodi i institucionit: _____
- d. Emri i Bankës së përfituesit : _____
- e. Numri i llogarisë bankare në lekë : _____
- f. Numri IBAN : _____
- g. Districti (TDO)/ kodi i degës së thesarit _____

Neni 8

Përgjegjësia e Përfituesit



1. Përfituesi është subjekti përgjegjës për zbatimin me efektivitet të projektit sipas Formularit të Projekt propozimit të plotë dhe formës së planifikimit financiar të projektit fitues.
2. AKKSHI-ja nuk mban asnjë përgjegjësi për dëmtime apo ankesa të shkaktuara nga dhe nëpërmjet projektit. Përfituesi mban të gjithë përgjegjësinë ndaj palëve të treta.
3. Përfituesi i grantit duhet të respektojë kërkesat e Kodit të Etikës së kërkimit shkencor, etikën e komunikimit me subjektet me të cilat bashkëpunon gjatë realizimit të projektit, si dhe detyrimet ligjore të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me pronësinë industriale.
4. Nëse gjatë realizimit të projektit, përfituesi i grantit përballet me situata që mund të çenojnë realizimin e projektit sipas planifikimit, zbatimin në kohë të aktiviteteve të parashikuara në projekt ose ndërprerjen e tyre, ai njofton menjëherë AKKSHI-në.
5. Të gjitha përgjegjësitë që lidhen me procesin e prokurimit, blerjes, vënies në punë dhe përdorimit të pajisjeve dhe mjeteve të blera me këtë grant në kuadër të projektit, janë të përfituesit.
6. Përfituesi ka detyrimin të zbatojë kuadrin ligjor në fuqi të prokurimit publik lidhur me procedurat e prokurimit.
7. Përfituesi ka detyrimin të mos bëjë ndryshime në listën e pajisjeve dhe specifikimeve teknike të tyre pas nënshkrimit të kontratës me AKKSHI.

Neni 9

Monitorimi/Kontrolli

1. Për çështjet që i takojnë monitorimit të objektit të kësaj Kontrate, përfituesi duhet t'i përgjigjet kërkesës së financuesit për monitorim të ecurisë së projektit, brenda 10 (dhjetë) ditë pune nga marrja e kërkesës.
2. Përfituesi duhet të ofrojë akses në institucion për monitoruesit e AKKSHI-it pas njoftimit paraprak të këtyre të fundit dhe të ofrojë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar lidhur me projektin (duke përfshirë informacionin financiar). Kjo përfshin dhe nënkupton informacion mbi të gjithë projektin dhe jo vetëm mbi pjesën e financuar me fonde nga AKKSHI-ja.
3. Përfituesi detyrohet të plotësojë kërkesat sipas përcaktimeve të parashikuara në kuadrin ligjor përkatës të Projekteve të infrastrukturës së kërkimit shkencor, të publikuar nga AKKSHI në faqen e saj zyrtare elektronike, dhe për të cilin Përfituesi merr njoftim edhe në rrugë elektronike pas shpalljes së Vendimit të Miratimit për Financim me Grante.
4. Përfituesi detyrohet të mbajë të gjithë dokumentacionin (duke përfshirë dokumentet financiare) lidhur me projektin të paktën 3 vjet pas përfundimit të tij. Gjithashtu, është i detyruar të ofrojë akses në këto dokumente ndaj çdo monitorimi që kryhet nga AKKSHI, apo çdo institucion tjetër që kanë kompetencë kontrollin e shpenzimeve të fondeve publike.

Neni 10

Transparenca, Publikimi dhe njohja e financimit

1. Përfituesi detyrohet të sigurojë transparencë të plotë mbi zbatimin e projektit dhe përdorimin e fondeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kërkesat e AKKSHI-së.



2. Përfituesi është i detyruar të publikojë në faqen zyrtare të institucionit dhe/ose në kanalet e tjera të komunikimit:
 - përshkrimin e projektit;
 - burimin e financimit;
 - rezultatet kryesore të arritura.
3. Në çdo material informues, shkencor apo promovues (përfshirë publikime, prezantime, konferenca, faqe interneti, raportime apo produkte të tjera të lidhura me projektin), Përfituesi detyrohet të njohë dhe të përmendë në mënyrë të qartë mbështetjen financiare të AKKSHI-së.
4. Përfituesi detyrohet të përdorë logon dhe identitetin vizual të AKKSHI-së, në përputhje me standardet dhe udhëzimet e përcaktuara nga kjo e fundit, në:
 - pajisjet dhe infrastrukturën e financuar;
 - ambientet ku vendoset infrastruktura;
 - materialet e komunikimit dhe publikimit.
5. Në çdo infrastrukturë kërkimore, publikimit apo prezantimit publik të produktit të prodhuar në kuadër të projektit, duhet të vendoset një mbishkrim i dukshëm me përmbajtje: "Mundësuar me mbështetjen financiare të AKKSHI_Ministria e Arsimit".
6. Me lidhjen e kësaj kontrate, përfituesi automatikisht lejon AKKSHI-në të publikojë dhe përdorë, për qëllime informimi dhe promovimi institucional:
 - emrin e përfituesit;
 - titullin dhe përshkrimin e projektit;
 - fondin e financuar;
 - rezultatet dhe materialet përkatëse.në çdo mënyrë që Agjencia e konsideron të dobishme.
7. Në rast se projekti parashikon produkte të shkruara të destinuara për publikim, përfituesi duhet t'i dorëzojë AKKSHI-së pesë (5) kopje për secilin publikim apo material të prodhuar në kuadër të projektit. Në rast se projekti parashikon produkte për publikim online, përfituesi duhet të vërë në dispozicion të AKKSHI-së të dhënat digjitale të publikimit (web, link, ISSN, etj).
8. Mosrespektimi i detyrimeve të këtij neni përbën shkelje kontraktuale dhe mund të sjellë masa administrative dhe/ose financiare sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate.

Neni 11

Pronësia dhe përdorimi i infrastrukturës kërkimore – shkencore

1. Infrastruktura kërkimore – shkencore e blerë me financimin e AKKSHI-së është në pronësi të përfituesit të grantit dhe pjesë e inventarit të institucionit të arsimit të lartë si aktiv i qëndrueshëm.
2. Infrastruktura kërkimore – shkencore e blerë me financimin e AKKSHI-së mund të vihet në dispozicion të palëve të treta, kundrejt marrëveshjes ndërmjet palëve.
3. Infrastruktura kërkimore – shkencore e blerë me financimin e AKKSHI-së duhet të mundësojë përdorimin e saj nga komuniteti kërkimor – shkencor i interesuar, në përputhje



me parimin e shkencës së hapur ("open science"), sipas përcaktimeve të ESFRI¹ (European Strategy Forum on Research and Infrastructures) dhe objektivave strategjike të Zonës Evropiane të Kërkimit (ERA)².

Neni 12 Ndryshimet e Kontratës

1. Ndryshimet thelbësore në mënyrën/metodën e realizimit të projektit mund të ndodhin vetëm pas miratimit nga Bordi i Administrimit të AKKSHI, pas paraqitjes së kërkesës zyrtare nga përfituesi me argumentimin përkatës.
2. Përfituesi i grantit njofton me shkrim AKKSHI-në në rast se ndodhin ndryshime në adresën, kontaktet, dhe numrin e llogarisë së përfituesit.
3. Çdo ndryshim tjetër në këtë Kontratë mund të bëhet vetëm nëpërmjet një akti shtesë të nënshkruar nga palët.

Neni 13 Ndërpreja e Kontratës

Kontrata mund të ndërpritet nëse:

1. Kjo Kontratë përfundon rregullisht sipas përcaktimit në Nenin 3 më sipër.
2. Përfituesi nuk zbaton projektin në cilësinë dhe sasinë e parashikuar në projektin objekt të kësaj Kontrate.
3. Kontrolli i Shtetit ose autoritete të tjera që sipas ligjit kanë të drejtë të kontrollojnë shpenzimet e fondeve buxhetore konstatojnë shkelje dhe kjo pranohet nga AKKSHI-ja.
4. AKKSHI mund të zgjidhë menjëherë këtë Kontratë, në rast se përfituesi shkel ndonjë prej detyrimeve të parashikuara në këtë Kontratë, apo në Legjislacionin shqiptar.
5. Ka Forca Madhore.

Neni 14 Shpenzime të lejueshme/të palejueshme

1. Të gjitha shpenzimet duhet të bëhen gjatë periudhës së zbatimit të projektit. Ato duhet të jenë reale dhe të lidhura me projektin e miratuar.
2. Shpenzimet e mëposhtme nuk janë të lejueshme dhe nuk mbulohen me fondin e Grantit që financoon Projektin:
 - a. Blerje e tokës;
 - b. Shit-blerje makinash;
 - c. Interes mbi huadhënie;
 - d. Marrëveshje huadhënie;
 - e. Dhurime;
 - f. Financim i partive politike apo organizatave e grupeve fetare;

¹ <https://www.esfri.eu/forum>

² https://ec.europa.eu/info/research-and-innovation/strategy/era_en



- g. Krijim i përfitimeve për anëtarët e Bordit, stafit apo të të afërmeve të tyre (përfshirë kompanitë në të cilat ato kanë interesa) nëpërmjet angazhimit në transaksione me ta apo të tjera shpërblime për pjesëmarrjen e tyre në aktivitete të projektit;
- h. Veprime në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 15 Sanksionet

1. Moszbatimi i detyrimeve për afatet e paraqitjes së raporteve financiare dhe atyre të programuara, sjell për pasojë në mënyrë të përshkallëzuar paralajmërimin e Përfituesit, ndërprerjen e financimit dhe përjashtimin nga financimi i projekteve për një periudhë 3 (tre) vjeçare.
2. Në rast se fondet e financuara me anë të këtij Granti, nuk janë shpenzuar sipas zërave të buxhetit të miratuar në Planin Plotë të Buxhetit që shoqëron këtë kontratë, apo konstatohen shpenzime të palejueshme sipas nenit 14 të kësaj kontrate, shuma e shpenzuar në shkelje të kontratës do t'i kthehet buxhetit të shtetit.
3. Në rast të ndërprerjes së realizimit të projektit nga ana e IAL-së Përfituese, duke mos u kufizuar vetëm në shkaqet e parashikuara në Nenin 13 të kësaj kontrate, AKKSHI i drejtohet gjykatës kompetente për rikuperimin e fondeve të lëvruara të Grantit që janë të papërdorura dhe/ose të pajustificuara me dokumentacionin ligjor përkatës për kryerjen e shpenzimeve në kuadër të Projektit, siç përmendet në Nenin 2 të kësaj kontrate.
4. Për shkeljet e përmendura në paragrafët 1-4 të këtij neni dhe kur nuk zbatohet asnjë afat i parapërcaktuar në këtë kontratë, AKKSHI-ja i drejtohet Gjykatës kompetente lidhur me mos përmbushjen e detyrimeve nga pala tjetër dhe zhdëmtimin eventual.

Neni 16 Zgjidhja e konflikteve

Në rastet e mosmarrëveshjeve midis palëve, ato do të kenë 30 ditë afat për zgjidhjen me mirëkuptim të konfliktit. Në qoftë se brenda kësaj periudhe nuk arrijnë në një marrëveshje, palët i drejtohen gjykatës kompetente.

Neni 17 Elementë të tjerë të Kontratës

1. Kjo kontratë përmban bashkëlidhur kopje të Aneksit 1: Projekt Propozimin dhe Aneksit 2: Buxhetin e miratuar nga Bordi i Administrimit të AKKSHI-së.
2. Anekset janë pjesë integrale dhe detyruese e kontratës.
3. Në rast mospërputhjeje, prevalon kjo Kontratë.

Neni 18 Të ndryshme



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

1. Ndryshimet dhe shtesat e kësaj Kontrate bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga palët.
2. Kjo Kontratë përbën marrëveshjen e plotë të palëve dhe përcakton në mënyrë ekskluzive afatet dhe kushtet lidhur me objektin e saj.
3. Për çështje që nuk parashikohen specifikisht në këtë Kontratë, palët do t'i referohen akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Kjo Kontratë është hartuar dhe lidhur në 3 kopje origjinale në gjuhën shqipe, nga të cilat 2 (dy) i mban AKKSHI-ja dhe 1 (një) Përfituesi.

Pasi u lexua nga palët, Kontrata nënshkruhet me vullnetin e tyre të lirë.

Kjo kontratë nënshkruhet nga:

Për AKKSHI

Znj.Z. _____
Drejtori i Përgjithshëm

Për Universitetin _____

Znj.Z. _____
Rektor

Znj.Z. _____
Drejtuesi i projektit

ANEKS 2. Forma e Propozimit Financiar

Forma e planifikimit të detajuar të buxhetit të projektit

IAL aplikuese: _____
Drejtuës i projektit: _____
Titulli i Projektit: _____

Nr.	Zërat e detajuar të shpenzimeve	Njësia	Sasia	Kosto për njësi (ALL) [1]	Totali	Shuma e kërkuar nga AKKSHI	Argumentimi i kostove [2]
	Shpenzime kapitale (bleje pajisje laboratorike)						
1							
2							
3							
4							
5							
	TOTAL						
	(Shuma e shpenzimeve të planifikuara të Projektit)						

DREJTUESI I PROJEKTI

ADMINISTRATORI I UNIVERSITETIT

DREJTUES I ZYRËS SË FINANCËS

REKTORI I UNIVERSITETIT

[1] Çmimi për njësi të përshjtitë të gjithë koston e blerjes së pajisjes dhe TVSH

[2] Jepni përshkrim narrativ të detajuar të specifikimeve teknike të pajisjes dhe funksionit që kryen.

KONTRATË

PËR ZBATIMIN E

PROJEKTIT TË

TEKNOLOGJISË

DHE

INFORMACIONIT

KONTRATË |

PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT TË TEKNOLOGJISË DHE INFORMACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT | AKKSHI



A series of handwritten signatures in blue ink are located at the bottom of the page. There are approximately seven distinct signatures, some appearing to be initials or full names, written in a cursive or semi-cursive style.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KONTRATË
PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT TË TEKNOLOGJISË DHE INFORMACIONIT
PËR VITIN _____**

Nr. Prot. _____,

Tiranë, më _____._____.2026

E lidhur sot, më datë _____._____.2026, ndërmjet palëve kontraktuese si më poshtë:

Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), me adresë Rruga "Naim Frashëri", Nr. 37 Tiranë, në cilësinë e **Financuesit**, përfaqësuar nga Znj/Z. _____, Drejtor i Përgjithshëm, me numër të letërnjoftimit _____.

Dhe

Universitetit _____, liçensuar me Vendimin Nr. _____, datë _____._____._____, të Këshillit të Ministrave, në cilësinë e **Përfituesit**, përfaqësuar nga rektori Znj/Z. _____, me numër të letërnjoftimit _____.

Palët në këtë kontratë bien dakord si më poshtë:

**Neni 1
Baza ligjore**

Kjo kontratë lidhet në bazë të neneve 109 -113 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 464, datë 31.07.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 607, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)", Vendimit nr.75, datë 12.2.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor" të Këshillit të Ministrave, si dhe Vendimit Nr. _____, datë _____._____.2026 "Për miratimin e financimit të projekteve fituese të teknologjisë dhe informacionit, për vitin 2026", të Bordit të Administrimit të AKKSHI - së.

**Neni 2
Objekti i Kontratës**

Objekti i kësaj Kontrate është financimi nga AKKSHI, në formë granti, për zbatimin e Projektit me titull: "_____", paraqitur nga Universiteti _____, në AKKSHI, nën programin e "Teknologjisë dhe informacionit", me drejtues projekti Znj/Z. _____.

**Neni 3
Periudha e zbatimit**



1. Kjo Kontratë hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të saj nga palët dhe përfundon me realizimin e të gjitha aktiviteteve të Projektit brenda afatit të parashikuar në kalendarin e projektit (pjesë integrale e kësaj Kontrate). Kontrata përfundon me dorëzimin e raportit përfundimtar nga Përfituesi dhe pranimin e këtij raporti nga Financuesi (AKKSHI). Rezultatet konsiderohen të përmbushura vetëm pas verifikimit dhe miratimit formal nga AKKSHI.
2. Zbatimi i kontratës fillon nga data e kalimit të fondit të projektit sipas buxhetit dhe planit të financimit të miratuar me Vendim Nr. _____, datë _____.2026 "Për miratimin e financimit të projekteve fituese të teknologjisë dhe informacionit, për vitin 2026", të Bordit të Administrimit të AKKSHI - së, në llogarinë e Përfituesit. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Përfituesi detyrohet të dorëzojë në rrugë zyrtare kalendarin e aktiviteteve të planifikuara të projektit dhe buxhetin e miratuar nga BA.

Neni 4

Shuma dhe mënyra e financimit të Projektit

Bazuar në Vendimit Nr. _____, datë _____.2026 "Për miratimin e financimit të projekteve fituese të teknologjisë dhe informacionit, për vitin 2026", të Bordit të Administrimit të AKKSHI - së, AKKSHI-ja do të mbështesë financiarisht zbatimin e projektit me shumën totale prej _____ (me fjalë) lekë.

Me lidhjen e kësaj kontrate, kjo shumë do të kalojë në llogarinë përfituesit duke specifikuar emërtimin e projektit.

Neni 5

Detyrimet e përfituesit

Përfituesi i grantit të financimit të projektit ka detyrimin që:

1. Të reflektojë në Projekt të gjitha ndryshimet që i janë propozuar lidhur me angazhimin e personave të përfshirë ne projekt, ndryshimet në buxhet, dhe sigurimin e dokumentacionit të domosdoshëm për mbarëvejtjen e projektit.
2. Të zbatojë projektin dhe të kryejë aktivitetet e planifikuara në përputhje me buxhetin e miratuar dhe planin financiar të projektit që i bashkëlidhet kësaj kontrate.
3. Të kthejë në buxhetin e shtetit, të gjitha fondet e pashpenzuara brenda 15 ditësh pas përfundimit të projektit, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.
4. Të garantojë funksionimin, mirëmbajtjen dhe përdorimin për qëllime kërkimore të teknologjisë së financuar për një periudhë jo më pak se 5 (pesë) vite nga data e përfundimit të projektit.
5. Të dorëzojë pranë AKKSHI-së raportet (e ndërmjetme dhe përfundimtare) teknike dhe financiare, shoqëruar me dokumentacionin përkatës ashtu siç është përcaktuar në nenin 7 të kësaj kontrate dhe anekset bashkëlidhur.

Neni 6

Detyrime të biznesit në bashkëpunim me përfituesin



_____ shpk., Universiteti _____, _____, duhet të përmbushin të gjitha detyrimet (financiare dhe jo financiare) që burojnë nga marrëveshja e bashkëpunimit me IAL-në, si dhe të japin kontributin e tyre gjatë zbatimit të projektit lidhur me aktivitetet e planifikuara dhe zërat e buxhetit sipas planit të buxhetiit pjesë integrale e kësaj kontrate.

Neni 7 Raportimi

1. Gjatë zbatimit të projektit, përfituesi i grantit raporton lidhur me ecurinë e zbatimit të projektit, në periudhë të ndërmjetme (pas gjysmës së periudhës së projektit), pas përfundimit të projektit dhe sa herë që kjo i kërkohet nga AKKSHI për aspekte të veçanta të ecurisë së tij. Forma e raportimit përcaktohet nga AKKSHI.
2. Në përfundim të zbatimit të projektit, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune, përfituesi i grantit dorëzon në AKKSHI, në 2 (dy) kopje, raportin përfundimtar teknik të realizimit të projektit, shoqëruar me shkresë përcjellëse nga rektori i institucionit të arsimit të lartë përfitues i grantit.
3. Raporti përfundimtar hartohet sipas formatit të AKKSHI dhe duhet të përmbajë:
 - a. Raportin përshkrues sipas formatit të përcaktuar nga AKKSHI dhe përcaktimeve të parashikuara në Udhëzuesin PTI të publikuar në faqen zyrtare të AKKSHI;
 - b. Raportin financiar, sipas formatit të përcaktuar nga AKKSHI dhe përcaktimeve të parashikuara në Udhëzuesin PTI të publikuar në faqen zyrtare të AKKSHI. Ky raport duhet të firmoset nga drejtuesi i projektit, financieri, administratori dhe rektori i institucionit të arsimit të lartë përfitues i grantit.
 - c. Produktet që janë realizuar sipas planit të aktiviteteve dhe buxhetit të miratuar, të cilat mund të jenë:
 - c.1. Artikuj shkencorë të publikuar në kuadër të projektit në revista shkencore. Në këtë rast dorëzohet 1 (një) kopje e printuar e artikullit, linku i botimit online (nëse është e mundur) si dhe të dhënat e tjera të botuesit;
 - c.2. Monografi shkencore. Në këtë rast dorëzohet 1 (një) kopje e printuar e monografisë, linku i botimit online (nëse është e mundur) si dhe të dhënat e tjera të botuesit;
 - c.3. Artikuj shkencorë ose prezantime në kuadër të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare që autori ka dërguar. Në këtë rast dorëzohet 1 (një) kopje e printuar e artikullit, kopje e librit përmbledhës të abstrakteve (Abstract Book), kopje e librit përmbledhës të punimeve/prezantimeve të konferencës (Proceedings book), linku i konferencës ku janë publikuar online dokumentat e sipërcituar.
 - c.4. Konferenca/workshope/seminare/etj. shkencore të organizuara në kuadër të projektit. Në këtë rast dorëzohen: agjenda, listëprezenca, përmbledhje, prezantime, foto të aktivitetit, linku përkatës nëse zhvillohet online, materiale të prodhuara për pjesëmarrësit (fletëpalosje, postera, banera, etj), si dhe çdo produkt tjetër të prodhuar.
 - c.5. Anketime, krijim databazash, modele, katalogje, etj. Në këtë rast dorëzohen të dhënat e mbledhura me CD/USB si dhe linku online nëse janë publikuar.



- c.6. Analiza laboratorike të kryera në kuadër të projektit. Në këtë rast dorëzohet lista e plotë dhe e detajuar e analizave që janë kryer, numri dhe lista e subjekteve që kanë shërbyer si kampion, lista e reagentëve që janë përdorur dhe rezultatet përfundimtare.
- c.7. Çdo produkt tjetër të prodhuar në kuadër të projektit.
4. Pas dorëzimit të raportit përfundimtar final, AKKSHI kontrollon nëse raporti dhe i gjithë dokumentacioni shoqërues është hartuar sipas kritereve të kërkuara.
- a. Në rast se raporti përfundimtar është kryer sipas kërkesave, institucioni përfitues merr konfirmimin nga AKKSHI për përmbylljen me sukses të projektit dhe shlyerjen e të gjitha detyrimeve që ka patur ndaj AKKSHI-së në kuadër të zbatimit të tij;
- b. Në rast të konstatimit të parregullsive, njoftohet përfituesi i grantit për plotësimin/korrigjimin e dokumentacionit brenda 10 (dhjetë) ditë pune;
- c. Një përmbledhje e produktit të projektit, e përkthyer në gjuhën angleze do të përgatitet nga Përfituesi dhe të publikohet në web faqen zyrtare të IAL-së dhe AKKSHI-së;
- d. Një video e rrugëtimit, zbatimit dhe përdorimit do të përgatitet nga Përfituesi dhe të publikohet në web faqen zyrtare të IAL-së dhe AKKSHI-së;
5. Në rastin kur institucioni përfitues i grantit shkel detyrimin lidhur me raportimet dhe realizimin e produktit/eve parashikuar në projektin e miratuar, AKKSHI kërkon auditimin e shumës së përfituar, deri në kthimin e tij në buxhetin e shtetit.

Neni 8

Të dhëna bankare të përfituesit:

- a. Emri i përfituesit të grantit: _____
- b. NIPT: _____
- c. Kodi i institucionit: _____
- d. Emri i Bankës së përfituesit : _____
- e. Numri i llogarisë bankare në lekë : _____
- f. Numri IBAN : _____
- g. Districti (TDO)/ kodi i degës së thesarit _____

Neni 9

Përgjegjësia e Përfituesit

1. Përfituesi është subjekti përgjegjës për zbatimin me efektivitet të projektit sipas Formularit të Projekt propozimit të plotë dhe formës së planifikimit financiar të projektit fitues.
2. AKKSHI-ja nuk mban asnjë përgjegjësi për dëmtime apo ankesa të shkaktuara nga dhe nëpërmjet projektit. Përfituesi mban të gjithë përgjegjësinë ndaj palëve të treta.
3. Përfituesi i grantit duhet të respektojë kërkesat e Kodit të Etikës së kërkimit shkencor, etikën e komunikimit me subjektet me të cilat bashkëpunon gjatë realizimit të projektit, si dhe detyrimet ligjore të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me pronësinë industriale.
4. Nëse gjatë realizimit të projektit, përfituesi i grantit përballet me situata që mund të çenojnë realizimin e projektit sipas planifikimit, zbatimin në kohë të aktiviteteve të



parashikuara në projekt ose ndërprerjen e tyre, ai njofton menjëherë AKKSHI-në, me të cilin dakordësojnë një kalendar të përditësuar të realizimit të aktiviteteve të projektit.

5. Përfituesi ka përgjegjësinë e plotë ligjore lidhur me zbatimin e procedurave financiare, të parashikuara nga kuadri ligjor përkatës në fuqi. Veprimtaria financiare e përfituesit gjatë zbatimit të projektit është subjekt i auditimit nga institucionet përkatëse audituese sipas parashikimeve ligjore në fuqi.
6. Përfituesi ka detyrimin të zbatojë kuadrin ligjor në fuqi të prokurimit publik lidhur me procedurat e prokurimit.

Neni 10

Monitorimi/Kontrolli

1. Për çështjet që i takojnë monitorimit të objektit të kësaj Kontrate, përfituesi duhet t'i përgjigjet kërkesës së financuesit për monitorim të ecursisë së projektit, brenda 10 (dhjetë) ditë pune nga marrja e kërkesës.
2. Përfituesi duhet të ofrojë akses në institucion për monitoruesit e AKKSHI-it pas njoftimit paraprak të këtyre të fundit dhe të ofrojë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar lidhur me projektin (duke përfshirë informacionin financiar). Kjo përfshin dhe nënkupton informacion mbi të gjithë projektin dhe jo vetëm mbi pjesën e financuar me fonde nga AKKSHI-ja.
3. Përfituesi detyrohet të plotësojë kërkesat sipas përcaktimeve të parashikuara në kuadrin ligjor përkatës të Projekteve të Teknologjisë dhe Inovacionit, të publikuar nga AKKSHI në faqen e saj zyrtare elektronike, dhe për të cilin Përfituesi merr njoftim edhe në rrugë elektronike pas shpalljes së Vendimit të Miratimit për Financim me Grante.
4. Përfituesi detyrohet të mbajë të gjithë dokumentacionin (duke përfshirë dokumentet financiare) lidhur me projektin të paktën 3 vjet pas përfundimit të tij. Gjithashtu, është i detyruar të ofrojë akses në këto dokumente ndaj çdo monitorimi që kryhet nga AKKSHI, apo çdo institucion tjetër që kanë kompetencë kontrollin e shpenzimeve të fondeve publike.

Neni 11

Transparenca, Publikimi dhe njohja e financimit

1. Përfituesi detyrohet të sigurojë transparencë të plotë mbi zbatimin e projektit dhe përdorimin e fondeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kërkesat e AKKSHI-së.
2. Përfituesi është i detyruar të publikojë në faqen zyrtare të institucionit dhe/ose në kanalet e tjera të komunikimit:
 - përshkrimin e projektit;
 - burimin e financimit;
 - rezultatet kryesore të arritura.
3. Në çdo material informues, shkencor apo promovues (përfshirë publikime, prezantime, konferenca, faqe interneti, raportime apo produkte të tjera të lidhura me projektin), Përfituesi detyrohet të njohë dhe të përmendë në mënyrë të qartë mbështetjen financiare të AKKSHI-së.



4. Përfituesi detyrohet të përdorë logon dhe identitetin vizual të AKKSHI-së, në përputhje me standardet dhe udhëzimet e përcaktuara nga kjo e fundit, në:
 - të gjitha materialet;
 - aktivitetet
 - produkte të përgatitura në kuadër të projektit;
 - materialet e komunikimit dhe publikimit.
5. Në çdo publikimit apo prezantimit publik të produktit të prodhuar në kuadër të projektit duhet të vendoset një mbishkrim i dukshëm me përmbajtje: "Mundësuar me mbështetjen financiare të AKKSHI_Ministria e Arsimit".
6. Me lidhjen e kësaj kontrate, përfituesi automatikisht lejon AKKSHI-në të publikojë dhe përdorë, për qëllime informimi dhe promovimi institucional:
 - emrin e përfituesit;
 - titullin dhe përshkrimin e projektit;
 - fondin e financuar;
 - rezultatet dhe materialet përkatëse.në çdo mënyrë që Agjencia e konsideron të dobishme.
7. Përfituesi, nuk mund të krijojë të ardhura nga shitja e botimeve të financuara në kuadër të këtij projekti.
8. Në rast se projekti parashikon produkte të shkruara të destinuara për publikim, përfituesi duhet t'i dorëzojë AKKSHI-së pesë (5) kopje për secilin publikim apo material të prodhuar në kuadër të projektit. Në rast se projekti parashikon produkte për publikim online, përfituesi duhet të vërë në dispozicion të AKKSHI-së të dhënat digjitale të publikimit (web, link, ISSN, etj).
9. Mosrespektimi i detyrimeve të këtij neni përbën shkelje kontraktuale dhe mund të sjellë masa administrative dhe/ose financiare sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate.

Neni 12

Pronësia dhe autorësia e produkteve të projektit

1. Marrëdhëniet e autorësisë dhe pronësisë së projektit rregullohen sipas legjislacionit mbi të drejtën e pronësisë intelektuale.
2. Përfituesi gëzon të drejtën e autorësisë për të gjitha botimet e realizuara në kuadër të financimit të projektit.
3. Financuesi gëzon të drejtën e pronësisë intelektuale për të gjitha botimet e realizuara në kuadër të financimit të projektit.

Neni 13

Ndryshimet e Kontratës

1. Ndryshimet thelbësore në mënyrën/metodën e realizimit të projektit mund të ndodhin vetëm pas miratimit nga Bordi i Administrimit të AKKSHI, pas paraqitjes së kërkesës zyrtare nga përfituesi me argumentimin përkatës.
2. Zgjatja në kohë e projektit behet vetëm në rastet kur shfaqen problematika që nuk varen nga zbatuesi i projektit. Në çdo rast, shtyrja e projektit bëhet vetëm me miratimin e



- AKKSHI-së, pasi përfituesi paraqet kërkesë me argumentat përkatëse, jo me vonë se 22 ditë pune përpara përfundimit të projektit.
3. Në rast të ndryshimit të drejtuesit ose anëtari të grupit kërkimor, përfituesi njofton me shkrim AKKSHI, ku argumenton ndryshimin dhe përcjell edhe të dhënat e personit/personave zëvendësues.
 4. Rishpërndarja e fondeve buxhetore bëhet vetëm me miratimin paraprak të AKKSHI-së. Ndryshimet në buxhet lejohen deri në kufirin 10% të buxhetit parashikuar për çdo zë të projektit, duke ruajtur totalin e buxhetit sipas rubrikave. Ndryshimet buxhetore të bëra si pasojë e rishpërndarjes duhet të reflektohen në raportin e ndërmjetëm/përfundimtar të projektit.
 5. Çdo ndryshim tjetër në këtë Kontratë mund të bëhet vetëm nëpërmjet një akti shtesë të nënshkruar nga palët.

Neni 14 Ndërprerja e Kontratës

Kontrata mund të ndërpritet nëse:

1. Kjo Kontratë përfundon rregullisht sipas përcaktimit në Nenin 3 më sipër.
2. Përfituesi nuk zbaton projektin në cilësinë dhe sasinë e parashikuar në projektin objekt të kësaj Kontrate.
3. Kontrolli i Shtetit ose autoritete të tjera që sipas ligjit kanë të drejtë të kontrollojnë shpenzimet e fondeve buxhetore konstatojnë shkelje dhe kjo pranohet nga AKKSHI-ja.
4. AKKSHI mund të zgjidhë menjëherë këtë Kontratë, në rast se përfituesi shkel ndonjë prej detyrimeve të parashikuara në këtë Kontratë, apo në Legjislacionin shqiptar.
5. Ka Forca Madhore.

Neni 15 Shpenzime të lejueshme/të palejueshme

1. Të gjitha shpenzimet duhet të bëhen gjatë periudhës së zbatimit të projektit. Ato duhet të jenë reale dhe të lidhura me projektin e miratuar.
2. Shpenzimet administrative brenda miratimit të buxhetit limit, duhet të jenë të lidhura direkt me aktivitetet specifike të projektit dhe jo me funksionimin e përgjithshëm të institucionit.
3. Shpenzimet e mëposhtme nuk janë të lejueshme dhe nuk mbulohen me fondin e Grantit që financon Projektin:
 - a. Blerje e tokës;
 - b. Shit-blerje makinash;
 - c. Interes mbi huadhënie;
 - d. Marrëveshje huadhënie;
 - e. Dhurime;
 - f. Financim i partive politike apo organizatave e grupeve fetare;



- g. Krijim i përfitimeve për anëtarët e Bordit, stafit apo të të afërmeve të tyre (përfshirë kompanitë në të cilat ato kanë interesa) nëpërmjet angazhimit në transaksione me ta apo të tjera shpërblime për pjesëmarrjen e tyre në aktivitete të projektit;
- h. Veprime në kundërshtim me legjislacionin në fuqi;
- i. Çdo shpenzim që nuk bën pjesë në buxhetin e miratuar nga BA, bashkëlidhur kësaj kontrate.

Neni 16 Sanksionet

1. Moszbatimi i detyrimeve për afatet e paraqitjes së raporteve financiare dhe atyre të programuara, sjell për pasojë në mënyrë të përshkallëzuar paralajmërimin e Përfituesit, ndërprerjen e financimit dhe përjashtimin nga financimi i projekteve për një periudhë 3 (tre) vjeçare.
2. Në rastin e mos përmbushjes së aktiviteteve të projektit apo kryerjes së shpenzimeve që nuk kanë qenë të lejuara, pjesa respektive e buxhetit do t'i kthehet AKKSHI-së brenda 7 (shtatë) ditëve.
3. Në rast të konstatimit të shkeljeve ligjore/etike gjatë zhvillimit të aktiviteteve të projektit, Përfituesi detyrohet t'i kthejë AKKSHI-së të gjithë shumën e grantit të financuar deri në kohën e konstatimit të kësaj shkeljeje.
4. Në rast se fondet e financuara me anë të këtij Granti, nuk janë shpenzuar sipas zërave të buxhetit të miratuar në Planin Plotë të Buxhetit që shoqëron këtë kontratë, apo konstatohen shpenzime të palejueshme sipas nenit 15 të kësaj kontrate, shuma e shpenzuar në shkelje të kontratës do t'i kthehet buxhetit të shtetit.
5. Në rast të ndërprerjes së realizimit të projektit nga ana e IAL-së Përfituese, duke mos u kufizuar vetëm në shkaqet e parashikuara në Nenin 13 të kësaj kontrate, AKKSHI i drejtohet gjykatës kompetente për rikuperimin e fondeve të lëvruara të Grantit që janë të papërdorura dhe/ose të pajustificuara me dokumentacionin ligjor përkatës për kryerjen e shpenzimeve në kuadër të Projektit, siç përmendet në Nenin 2 të kësaj kontrate.
6. Për shkeljet e përmendura në paragrafët 1-5 të këtij neni dhe kur nuk zbatohet asnjë afat i parapërcaktuar në këtë kontratë, AKKSHI-ja i drejtohet Gjykatës kompetente lidhur me mos përmbushjen e detyrimeve nga pala tjetër dhe zhdëmtimin eventual.

Neni 17 Zgjidhja e konflikteve

Në rastet e mosmarrëveshjeve midis palëve, ato do të kenë 30 ditë afat për zgjidhjen me mirëkuptim të konfliktit. Në qoftë se brenda kësaj periudhe nuk arrijnë në një marrëveshje, palët i drejtohen gjykatës kompetente.

Neni 18 Elementë të tjerë të Kontratës



1. Kjo kontratë përmban bashkëlidhur kopje të Aneksit 1: Projekt Propozimin, Aneksit 2: Buxhetin e miratuar nga Bordi i Administrimit të AKKSHI-së dhe Aneksit 3: Kalendarin e aktiviteteve.
2. Anekset janë pjesë integrale dhe detyruese e kontratës.
3. Në rast mospërputhjeje, prevalon kjo Kontratë.

Neni 19 Të ndryshme

1. Ndryshimet dhe shtesat e kësaj Kontrate bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga palët.
2. Kjo Kontratë përbën marrëveshjen e plotë të palëve dhe përcakton në mënyrë ekskluzive afatet dhe kushtet lidhur me objektin e saj.
3. Për çështje që nuk parashikohen specifikisht në këtë Kontratë, palët do t'i referohen akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Kjo Kontratë është hartuar dhe lidhur në 3 kopje origjinale në gjuhën shqipe, nga të cilat 2 (dy) i mban AKKSHI-ja dhe 1 (një) Përfituesi.

Pasi u lexua nga palët, Kontrata nënshkruhet me vullnetin e tyre të lirë.

Kjo kontratë nënshkruhet nga:

Për AKKSHI

Znj.Z. _____
Drejtori i Përgjithshëm

Për Universitetin _____

Znj.Z. _____
Rektor

Znj.Z. _____
Drejtuesi i projektit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT

KALENDAR I AKTIVITETEVE | PËR PROJEKTIN SHKENCOR TË FINANCUAR NGA AKKSHI
PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT TË TEKNOLOGJISË DHE INFORMACIONIT 202__

Objektivi	Aktiviteti ¹	Rezultati	Periudha kohore	Personi përgjegjës
-----------	-------------------------	-----------	-----------------	--------------------

VITI I PARË

Aktiviteti/Muaji	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
------------------	---	---	---	---	---	---	---	---	---	----	----	----

VITI I DYTË

Aktiviteti/Muaji	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24
------------------	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----	----

VITI I TRETË (Publikim artikull/artikuj)

Aktiviteti/Muaji	25	26	27	28	29	30
------------------	----	----	----	----	----	----

Drejtesi i Projektit

Drejtesi i Agjencisë Ekzekutive
Rektori i Universitetit

¹ Aktivitetet dhe periudha kohore e tabelave sipas viteve duhet të jenë të njejta dhe të përkojnë me aktivitetet dhe periudhën kohore në tabelën përmbledhëse.

ANEKS KONTRATË | KALENDAR I AKTIVITETEVE

PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT TË TEKNOLOGJISË DHE INFORMACIONIT

AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT AKKSHI

ANEKS 2. Forma e Propozimit Financiar

Forma e planifikimit të detajuar të buxhetit të projektit

Aplikanti (Agjencia Ekzekutive):

Drejtes i projektit:

Titulli i Projektit:

Nr.	Zërat e detajuar të shpenzimeve	Njësia	Sasia	Kosto për njësi në lekë	Totali	Shuma e kërkuar nga AKKSHI	Shuma e mbuluar nga partneri ne projekt Biznesi/institucioni	Argumentimi i kostove [7]
1	Pagesë për personelin (përshirë sigurimet shoqërore dhe shëndetësore)							
	Pagat për burimet njerëzore[1]							
1.1	Drejtes i projektit (emër, mblëmër)	ditë pune						
	Grupi i punës[2] (detajo)							
1.2	Anetar grupi 1 (emër, mblëmër)	ditë pune						
1.3	Anetar grupi 2 (emër, mblëmër)	ditë pune						
1.4	Anetar grupi 3 (emër, mblëmër)	ditë pune						
1.5	Anetar grupi 4 (emër, mblëmër)	ditë pune						
1.6	Anetar grupi 5 (emër, mblëmër)	ditë pune						
	Stafi mbështetës administrativ dhe teknik [3] (detajo)							
1.7	Staf mbështetës 1 (emër, mblëmër)	ditë pune						
1.8	Staf mbështetës 2 (emër, mblëmër)	ditë pune						
	Totali Zëri 1							
2	Udhëtime dhe Dieta							
	Udhëtime dhe dieta[4]							
2.1	Dieta (brenda vendit)	ditë		2500				
2.2	Akomodimi (brenda vendit)	për/natë		3000				

[1] Paga e personelit të angazhuar në projekt përcaktohet në përputhje me kategorinë e vendit të punës, referuar Lidhjes nr.1 të VKM nr. 243, datë 20.4.2023, "Për një ndryshim në vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë". Përfutjesit nga institucionet jopublike janë të detyruar të kenë të njëjtën referencë për pagesat e personelit të angazhuar në projekt.

*Zëri paga për personelin duhet të zërrë jo më shumë se 50% të buxhetit të projektit të kërkuar nga AKKSHI. *Numri i ditëve të angazhimit në projekt është jo më shumë se 40 ditë /pune në 12 muaj/person. Numri maksimal i ditëve të angazhimit është 80 ditë/pune 24 muaj/person. Periudha 6 mujore e planifikuar për publikimin e artikullit/artikujve shkencor nuk përfshin ditë angazhimi me pagesë nga AKKSHI. Vërtetimi i bazeës për çdo anëtar të arutit të punës duhet i ateneruar naa e-albania me datën më të afërt të aplikimit.

[2] Grupi i punës ndër të tjera mund të përfshijë pozicione punë: kërkues shkencorë, pedagogë, bashkëpunëtorë shkencorë etj

[3] Staf i ndihmës është personeli që nuk kontribuon në kërkim shkencor por ka një kontribut në administrimin e aktivitetit të projektit.

[4] Aplikanti do të duhet të argumentojë udhëtimet në funksion të realizimit të aktiviteve dhe objektivave të Projektit. Gjatë implementimit të projektit, shpenzimet e udhëimit do të justifikohen me dokumentat përkatëse. Shpenzimet për dieta, akomodim, transport publik do të bëhen sipas VKM Nr.329, datë 20.04.2016 "Për disa ndryshime në vendimin Nr.997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit" të ndryshuar. *Nuk lejohen udhëtimet jashtë vendit.

[5] Përfutjesi i grantit ka detyrimin: a) të vendosë logon e AKKSHI-së në të gjithë informacionin lidhur me publikimet, aktivitetet që janë mundësuar me ndihmën financiare të AKKSHI-së, si dhe mbi të gjitha materialet, aktivitetet, faqet zyrtare të internetit dhe të tjera produkte; b) të përmendë financimin AKKSHI në të gjitha artikujt/botimet e financuara në kuadër të projektit.

[5.1] Artikuj të botuar në revista ndërkombëtare të indeksuara në Scopus, me indikator citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikator citimit të Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI), VKM Nr. 128, datë 6.3.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 112, datë 23.2.2018, të Këshillit të ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore 'Doktor' dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë 'Profesor' dhe 'Profesor', të ndryshuar". Një artikulli i publikuar në revistat e mësipërme është produkt i detyruar i projektit.

[5.2] Revista të kategorisë A,B,C referuar Urdhërit Nr. 36 date 24.1 2023 "Për miratimin e rregullores për krijimin e regjistrit shtetëror të revistave shkencore që botohen në Republikën e Shqipërisë",për kategoritë e revistave brenda vendit

[5.3] Monografi/libra/ revista /buletine që plotësojnë kriteret e përcaktuara nga legjislati në fuqi. Monografia duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në VKM Nr. 112, datë 23.2.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i asociuar" dhe "Profesor", Kreu II, pika 5, shkrnja "d".

[5.4] Prezantim në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuar në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN, sipas VKM Nr. 112, datë 23.2.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i asociuar" dhe "Profesor"

[5.5] Konferencë shkencore në përputhje me kriteret e Vendimin nr. 112, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore 'Doktor' dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë 'Profesor i asociuar' dhe 'Profesor", të ndryshuar"

[6] Në shpenzimet administrative do të futen vetëm ato shpenzime që do të përdoren për materiale për pjesëmarrësit në konferencë shkencore.

[6.1] Organizimi i konferencës shkencore për diseminimin e rezultateve të projektit është i detyruar.

[7] Argumentimi i kostove është i detyrueshëm dhe duhet i detajuar për çdo zë të listuar në formën financiare.

KONTRATË

PËR

FINANCIMIN

E STUDIMEVE

TË

DOKTORATURËS

KONTRATË |

PËR FINANCIMIN E STUDIMEVE TË DOKTORATURËS

AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT | AKKSHI



A handwritten signature in blue ink, located in the bottom left corner of the page.

A handwritten signature in blue ink, located in the bottom center-left of the page.

A handwritten signature in blue ink, located in the bottom center-right of the page.

A handwritten signature in blue ink, located in the bottom right corner of the page.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KONTRATË
PËR FINANCIMIN E STUDIMEVE TE DOKTORATURËS
PËR VITIN _____**

Nr. Prof. _____,

Tiranë, më _____._____.2026

E lidhur sot, më datë _____._____.2026, ndërmjet palëve kontraktuese si më poshtë:

Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), me adresë Rruga "Naim Frashëri", Nr. 37 Tiranë, në cilësinë e **Financuesit**, përfaqësuar nga Znj/Z. _____, Drejtor i Përgjithshëm, me numër të letërnjoftimit _____.

Dhe

Universitetit Politeknik të Tiranës, liçensuar me Vendimin Nr. 215, datë 15.07.1991, të Këshillit të Ministrave, në cilësinë e **Përfituesit**, përfaqësuar nga rektori Znj/Z. _____, me numër të letërnjoftimit _____.

Palët në këtë kontratë bien dakord si më poshtë:

**Neni 1
Baza ligjore**

Kjo kontratë lidhet në bazë të neneve 109 -113 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 464, datë 31.07.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 607, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)", Vendimit nr.75, datë 12.2.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor" të Këshillit të Ministrave, si dhe Vendimit Nr. _____, datë _____._____.2026 "Për miratimin e financimit të Studimeve të Doktoraturës, për vitin 2026", të Bordit të Administrimit të AKKSHI - së, të Bordit të Administrimit të AKKSHI - së.

**Neni 2
Objekti i Kontratës**

Objekti i kësaj Kontrate është financimi nga AKKSHI, në formë granti, për kërkimin shkencor për marrjen e gradës shkencore "Doktor" paraqitur nga studentët e Ciklit të Tretë të studimeve "Doktoratë" të regjistruar në Universitetin _____, në AKKSHI, për zbatimin e Projektit me titull: " _____", nën programin për financimin e Studimeve të Doktoraturës, për Vitin 2026, me drejtues projekti Dr. Kandidat Znj.Z. _____.

Neni 3



Periudha e zbatimit

1. Kjo Kontratë hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të saj nga palët dhe përfundon me realizimin e të gjitha aktiviteteve të Projektit brenda afatit të parashikuar në kalendarin e projektit (pjesë integrale e kësaj Kontrate). Kontrata përfundon me dorëzimin e raportit përfundimtar nga Përfituesi, përgatitur nga Studenti i Doktoratures dhe pranimin e këtij raporti nga Financuesi (AKKSHI). Rezultatet konsiderohen të përmbushura vetëm pas verifikimit dhe miratimit formal nga AKKSHI.
2. Zbatimi i kontratës fillon nga data e kalimit të fondit të projektit sipas buxhetit dhe planit të financimit të miratuar me Vendim Nr. _____, datë _____.2026 "Për miratimin e financimit të studimeve të doktoraturës, për vitin 2026", të Bordit të Administrimit të AKKSHI - së, në llogarinë e Përfituesit. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Përfituesi detyrohet të dorëzojë në rrugë zyrtare kalendarin e aktiviteteve të planifikuara të projektit dhe buxhetin e miratuar nga BA.

Neni 4

Shuma dhe mënyra e Financimit të Projektit

Bazuar në Vendimit Nr. _____, datë _____.2026 "Për miratimin e financimit të studimeve të doktoraturës, për vitin 2026", të Bordit të Administrimit të AKKSHI - së, AKKSHI-ja do të mbështesë financiarisht zbatimin e projektit të kërkimit shkencor për marrjen e gradës shkencore "Doktor", me shumën totale prej _____ (me fjalë) lekë. Me lidhjen e kësaj kontrate, kjo shumë do të kalojë në llogarinë përfituesit duke specifikuar emërtimin e projektit.

Neni 5

Detyrimet e përfituesit, IAL

Në përmbushje të kësaj kontrate Universiteti i Tiranës, ka detyrimin:

1. Të përmbushë të gjitha detyrimet (financiare dhe jo financiare) që burojnë nga kjo kontratë.
2. Të ushtrojë kontroll (përmes strukturave përgjegjëse dhe udhëheqësit shkencor), për zbatimin e kalendarit të veprimtarive dhe përdorimin e fondit të studentit përfitues sipas planit të buxhetit pjesë integrale e kësaj kontrate, në përputhje me Vendimin e BA dhe kontratën e lidhur me AKKSHI.
3. Të përcjellë në AKKSHI, sa herë dhe në formën që i kërkohet, raporte dhe informacione lidhur me ecurinë e veprimtarive të projektit për çdo student përfitues si dhe mënyrën e përdorimit të fondit.
4. Të komunikojë dhe ofrojë bashkëpunim me AKKSHI-në për çdo problematikë të mundshme gjatë periudhës së financimit.
5. Të përcjellë në AKKSHI, në formë zyrtare, çdo dokumentacion që do të prodhohet në kuadër të komunikimit institucional gjatë periudhës së zbatimit të kësaj kontrate.



6. Të sigurojë zbatimin e kërkesave të Kodit të Etikës së kërkimit shkencor, etikën e komunikimit me subjektet me të cilat IAL bashkëpunon gjatë realizimit të projektit si dhe detyrimet ligjore të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me pronësinë industriale.
7. IAL ndan me doktorantin përgjegjës në ndaj palëve të treta për dëmtime apo ankesa të shkaktuara nga dhe nëpërmjet projektit.
8. Nëse gjatë realizimit të projektit, evidentohen shkaqe për mos zbatim të aktiviteteve të parashikuara në projekt ose ndërprerje të tyre, të njoftojë menjëherë AKKSHI-në, me të cilin dakordësojnë një kalendar të përditësuar të realizimit të aktiviteteve të projektit.
9. IAL ka përgjegjësinë e plotë ligjore lidhur me zbatimin e procedurave financiare, të parashikuara nga kuadri ligjor përkatës në fuqi. Veprimtaria financiare e përfituesit gjatë zbatimit të projektit është subjekt i auditimit nga institucionet përkatëse audituese sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

Neni 6 Raportimi

1. Gjatë zbatimit të projektit, IAL dhe studenti doktorant si përfitues i grantit raporton lidhur me ecurinë e zbatimit të projektit, në periudhë të ndërmjetme (pas gjysmës së periudhës së projektit), pas përfundimit të projektit dhe sa herë që kjo i kërkohet nga AKKSHI për aspekte të veçanta të ecurisë së tij. Forma e raportimit përcaktohet nga AKKSHI.
2. Në përfundim të zbatimit të projektit, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune, përfituesi i grantit dorëzon në AKKSHI, në 2 (dy) kopje, raportin përfundimtar teknik të realizimit të projektit, shoqëruar me shkresë përcjellëse nga rektori i institucionit të arsimit të lartë përfitues i grantit.
3. Raporti përfundimtar hartohet sipas formatit të AKKSHI dhe duhet të përmbajë:
 - a. Raportin përmbledhës sipas formatit të përcaktuar nga AKKSHI;
 - b. Produktin që është realizuar, që mund të jenë:
 - b.1. Artikuj shkencorë të publikuar në kuadër të projektit në revista shkencore. Në këtë rast dorëzohet 1 (një) kopje e printuar e artikullit, linku i botimit online (nëse është e mundur) si dhe të dhënat e tjera të botuesit;
 - b.2. Monografi shkencore. Në këtë rast dorëzohet 1 (një) kopje e printuar e monografisë, linku i botimit online (nëse është e mundur) si dhe të dhënat e tjera të botuesit;
 - b.3. Artikuj shkencorë ose prezantime në kuadër të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare që autori ka dërguar. Në këtë rast dorëzohet 1 (një) kopje e printuar e artikullit, kopje e librit përmbledhës të abstrakteve (Abstract Book), kopje e librit përmbledhës të punimeve/prezantimeve të konferencës (Proceedings book), linku i konferencës ku janë publikuar online dokumentat e sipërcituar.
 - b.4. Konferenca/workshope/seminare/etj. shkencore të organizuara në kuadër të projektit. Në këtë rast dorëzohen: agjenda, listëprezenca, përmbledhje, prezantime, foto të aktivitetit, linku përkatës nëse zhvillohet online, materiale të prodhuara për pjesëmarrësit (fletëpalosje, postera, banera, etj), si dhe çdo produkt tjetër të prodhuar.



- b.5. Anketime, krijim databazash, modele, katalogje, etj. Në këtë rast dorëzohen të dhënat e mbledhura me CD/USB si dhe linku online nëse janë publikuar.
- b.6. Analiza laboratorike të kryera në kuadër të projektit. Në këtë rast dorëzohet lista e plotë dhe e detajuar e analizave që janë kryer, numri dhe lista e subjekteve që kanë shërbyer si kampion, lista e reagentëve që janë përdorur dhe rezultatet përfundimtare.
- b.7. Çdo produkt tjetër të prodhuar në kuadër të projektit.
- c. Raportin financiar, sipas formatit të përcaktuar nga AKKSHI (Lista e detajuar e shpenzimeve LDSH) të shoqëruar me kopje të faturave të shpenzimeve, të firmosur nga drejtuesi i projektit, financieri, dhe administratori dhe titullari i Përfituesit të grantit;
- d. Foto të aktiviteteve të zhvilluara gjatë zbatimit të projektit;
- e. Kopje (link) të artikullit shkencorë të publikuar, apo të çdo botimi që mund të jetë realizuar në kuadrin e projektit të financuar nga AKKSHI shoqëruar me link-un përkatës nëse gjendet online. Botimet duhet të kenë logon e AKKSHI, të shoqërohen me shënimin që janë realizuar në kuadër të Programit të Doktoratës 2025.
- f. Çdo veprimtari e zhvilluar apo produkt i prodhuar duhet të ketë logon e AKKSHI dhe të shoqërohet me shënimin që është realizuar në kuadër të projektit të financuar nga AKKSHI dhe nuk shiten, por janë pronë e institucionit financues të grantit.
- g. Një përmbledhje e produktit të projektit, e përkthyer në gjuhën angleze do të publikohet në web faqen zyrtare të IAL-së dhe AKKSHI-së;
4. Pas dorëzimit të raportit final, AKKSHI kontrollon nëse raporti dhe i gjithë dokumentacioni shoqëruar është hartuar sipas kriterëve të kërkuara.
5. Në rast se raportimi final është kryer sipas kërkesave, IAL dhe studenti i doktoratës marrin konfirmimin nga AKKSHI për përmbylljen me sukses të projektit dhe shlyerjen e të gjitha detyrimeve që ka patur në kuadër të zbatimit të tij.
6. Në rast të konstatimit të parregullsive, njoftohen IAL dhe studenti i doktoratës i grantit për plotësimin / korrigjimin e dokumentacionit brenda 10 (dhjetë) ditë pune.
7. Në rastin kur IAL dhe/apo studenti i doktoratës shkelin detyrimin lidhur me raportimet, të ndërmjetme apo përfundimtare, AKKSHI kërkon kthimin e shumës së përfituar nga financimi.

Neni 7

Të dhëna bankare të përfituesit:

- a. Emri i përfituesit të grantit: _____
- b. NIPT: _____
- c. Kodi i institucionit: _____
- d. Emri i Bankës së përfituesit : _____
- e. Numri i llogarisë bankare në lekë : _____
- f. Numri IBAN : _____
- g. Districti (TDO)/ kodi i degës së thesarit _____

Neni 8

Përgjegjësia e Përfituesit



1. Përfituesi është subjekti përgjegjës për zbatimin me efektivitet të studimit të doktoraturës.
2. AKKSHI-ja nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj palëve të treta.
3. Përfituesi i grantit duhet të respektojë kërkesat e Kodit të Etikës së kërkimit shkencor, etikën e komunikimit me subjektet me të cilat bashkëpunon gjatë realizimit të studimit, si dhe detyrimet ligjore të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me pronësinë industriale.
4. Nëse gjatë realizimit të projektit, përfituesi i grantit përballlet me situata që mund të çojnë realizimin e projektit sipas planifikimit, zbatimin në kohë të studimit, ai njofton menjëherë AKKSHI-në, me të cilin dakordësojnë një kalendar të përditësuar.
5. Përfituesi ka përgjegjësinë e plotë ligjore lidhur me zbatimin e procedurave financiare, të parashikuara nga kuadri ligjor përkatës në fuqi. Veprimtaria financiare e përfituesit gjatë zbatimit të projektit është subjekt i auditimit nga institucionet përkatëse audituese sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

Neni 9 Monitorimi/Kontrolli

1. Për çështjet që i takojnë monitorimit të objektit të kësaj Kontrate, përfituesi duhet t'i përgjigjet kërkesës së financuesit për monitorim të ecurisë së projektit, brenda 10 (dhjetë) ditë pune nga marrja e kërkesës.
2. Përfituesi duhet të ofrojë akses në institucion për monitoruesit e AKKSHI-it pas njoftimit paraprak të këtyre të fundit dhe të ofrojë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar lidhur me projektin (duke përfshirë informacionin financiar). Kjo përfshin dhe nënkupton informacion mbi të gjithë projektin dhe jo vetëm mbi pjesën e financuar me fonde nga AKKSHI-ja.
3. Përfituesi detyrohet të plotësojë kërkesat sipas përcaktimeve të parashikuara në kuadrin ligjor përkatës të Projekteve për mbështetjen e studimeve të doktoraturës, të publikuar nga AKKSHI në faqen e saj zyrtare elektronike, dhe për të cilin Përfituesi merr njoftim edhe në rrugë elektronike pas shpalljes së Vendimit të Miratimit për Financim me Grante.
4. Përfituesi detyrohet të mbajë të gjithë dokumentacionin (duke përfshirë dokumentet financiare) lidhur me projektin të paktën 3 vjet pas përfundimit të tij. Gjithashtu, është i detyruar të ofrojë akses në këto dokumente ndaj çdo monitorimi që kryhet nga AKKSHI, apo çdo institucion tjetër që kanë kompetencë kontrollin e shpenzimeve të fondeve publike.

Neni 10 Transparenca, Publikimi dhe njohja e financimit

1. Përfituesi detyrohet të sigurojë transparencë të plotë mbi zbatimin e projektit dhe përdorimin e fondeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kërkesat e AKKSHI-së.
2. Përfituesi është i detyruar të publikojë në faqen zyrtare të institucionit dhe/ose në kanalet e tjera të komunikimit:
 - përshkrimin e projektit;
 - burimin e financimit;



- rezultatet kryesore të arritura.
- 3. Në çdo material informues, shkencor apo promovues (përfshirë publikime, prezantime, konferenca, faqe interneti, raportime apo produkte të tjera të lidhura me projektin), Përfituesi detyrohet të njohë dhe të përmendë në mënyrë të qartë mbështetjen financiare të AKKSHI-së.
- 4. Përfituesi detyrohet të përdorë logon dhe identitetin vizual të AKKSHI-së, në përputhje me standardet dhe udhëzimet e përcaktuara nga kjo e fundit, në:
 - të gjitha materialet;
 - aktivitetet
 - produkte të përgatitura në kuadër të projektit;
 - materialet e komunikimit dhe publikimit.
- 5. Në çdo publikimit apo prezantimit publik të produktit të prodhuar në kuadër të projektit duhet të vendoset një mbishkrim i dukshëm me përmbajtje:
"Mundësuar me mbështetjen financiare të AKKSHI_Ministria e Arsimit. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e autorit, opinioni i shprehur në të nuk është domosdoshmërisht opinion i AKKSHI-së".
- 6. Me lidhjen e kësaj kontrate, përfituesi automatikisht lejon AKKSHI-në të publikojë dhe përdorë, për qëllime informimi dhe promovimi institucional:
 - emrin e përfituesit;
 - titullin dhe përshkrimin e projektit;
 - fondin e financuar;
 - rezultatet dhe materialet përkatëse.në çdo mënyrë që Agjencia e konsideron të dobishme.
- 7. Në rast se projekti parashikon produkte të shkruara të destinuara për publikim, përfituesi duhet t'i dorëzojë AKKSHI-së dy (2) kopje për secilin publikim apo material të prodhuar në kuadër të projektit. Në rast se projekti parashikon produkte për publikim online, përfituesi duhet të vërë në dispozicion të AKKSHI-së të dhënat digjitale të publikimit (web, link, ISSN, etj).
- 8. Mosrespektimi i detyrimeve të këtij neni përbën shkelje kontraktuale dhe mund të sjellë masa administrative dhe/ose financiare sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate.

Neni 11

Pronësia dhe autorësia e produkteve të projektit

1. Marrëdhëniet e autorësisë dhe pronësisë së projektit rregullohen sipas legjislacionit mbi të drejtën e pronësisë intelektuale.
2. E drejta e autorësisë për të gjitha botimet e realizuara në kuadër të financimit të projektit rregullohet midis IAL dhe studentit doktorant ashtu siç është parashikuar në rregulloren përkatëse të Shkollës Doktorale.
3. Financuesi gëzon të drejtën e pronësisë intelektuale për të gjitha botimet e realizuara në kuadër të financimit të projektit.

Neni 12

Ndryshimet e Kontratës



1. Ndryshimet thelbësore në mënyrën/metodën e realizimit të projektit mund të ndodhin vetëm pas miratimit nga Bordi i Administrimit të AKKSHI, pas paraqitjes së kërkesës zyrtare nga studentë doktorantë përmes IAL, me argumentimin përkatës.
2. Zgjatja në kohë e projektit bëhet vetëm në rastet kur shfaqen problematika që nuk varen nga zbatuesi i projektit. Në çdo rast, shtyrja e projektit bëhet vetëm me miratimin e AKKSHI-së, pasi përfituesi paraqet kërkesë me argumentat përkatëse, jo me vonë se 22 ditë pune përpara përfundimit të projektit.
3. Çdo ndryshim tjetër në këtë Kontratë mund të bëhet vetëm nëpërmjet një akti shtesë të nënshkruar nga palët.

Neni 13

Ndërprerja e Kontratës

Kontrata mund të ndërpritet nëse:

1. Kjo Kontratë përfundon rregullisht sipas përcaktimit në Nenin 3 më sipër.
2. Përfituesi nuk zbaton projektin në cilësinë dhe sasinë e parashikuar në projektin objekt të kësaj Kontrate.
3. Kontrolli i Shtetit ose autoritete të tjera që sipas ligjit kanë të drejtë të kontrollojnë shpenzimet e fondeve buxhetore konstatojnë shkelje dhe kjo pranohet nga AKKSHI-ja.
4. AKKSHI mund të zgjidhë menjëherë këtë Kontratë, në rast se përfituesi shkel ndonjë prej detyrimeve të parashikuara në këtë Kontratë, apo në Legjislacionin shqiptar.
5. Ka Forca Madhore.

Neni 14

Shpenzime të lejueshme/të palejueshme

1. Të gjitha shpenzimet duhet të bëhen gjatë periudhës së zbatimit të projektit. Ato duhet të jenë reale dhe të lidhura me studimin.
2. Shpenzimet duhet të jenë të lidhura direkt me aktivitetet specifike të studimit.
3. Shpenzimet e mëposhtme nuk janë të lejueshme dhe nuk mbulohen me fondin e Grantit që financohet Projektin:
 - a. Blerje e tokës;
 - b. Shit-blerje makinash;
 - c. Interes mbi huadhënie;
 - d. Marrëveshje huadhënie;
 - e. Dhurime;
 - f. Financim i partive politike apo organizatave e grupeve fetare;
 - g. Krijim i përfitimeve për anëtarët e Bordit, stafit apo të të afërmeve të tyre (përfshirë kompanitë në të cilat ato kanë interesa) nëpërmjet angazhimit në transaksione me ta apo të tjera shpërblime për pjesëmarrjen e tyre në aktivitete të projektit;
 - h. Veprime në kundërshtim me legjislacionin në fuqi;
 - i. Çdo shpenzim që nuk bën pjesë në buxhetin e miratuar nga BA, bashkëlidhur kësaj kontrate.



Neni 15 Sanksionet

1. Moszbatimi i detyrimeve për afatet e paraqitjes së raporteve financiare dhe atyre të programuara, sjell për pasojë në mënyrë të përshkallëzuar paralajmërimin e Përfituesit, ndërprerjen e financimit dhe përjashtimin nga financimi i projekteve për një periudhë 3 (tre) vjeçare.
2. Në rastin e mos përmbushjes së aktiviteteve të projektit apo kryerjes së shpenzimeve që nuk kanë qenë të lejuara, pjesa respektive e buxhetit do t'i kthehet AKKSHI-së brenda 7 (shtatë) ditëve.
3. Në rast të konstatimit të shkeljeve ligjore/etike gjatë zhvillimit të aktiviteteve të projektit, Përfituesi detyrohet t'i kthejë AKKSHI-së të gjithë shumën e grantit të financuar deri në kohën e konstatimit të kësaj shkeljeje.
4. Në rast se fondet e financuara me anë të këtij Granti konstatohen shpenzime të palejueshme sipas nenit 14 të kësaj kontrate, shuma e shpenzuar në shkelje të kontratës do t'i kthehet buxhetit të shtetit.
5. Në rast të ndërprerjes së realizimit të projektit nga ana e IAL-së Përfituese dhe doktorantit, duke mos u kufizuar vetëm në shkaqet e parashikuara në Nenin 13 të kësaj kontrate, AKKSHI i drejtohet gjykatës kompetente për rikuperimin e fondeve të lëvruara të Grantit që janë të papërdorura dhe/ose të pajustificuara me dokumentacionin ligjor përkatës për kryerjen e shpenzimeve në kuadër të Projektit, siç përmendet në Nenin 2 të kësaj kontrate.
6. Për shkeljet e përmendura në paragrafët 1-5 të këtij neni dhe kur nuk zbatohet asnjë afat i parapërcaktuar në këtë kontratë, AKKSHI-ja i drejtohet Gjykatës kompetente lidhur me mos përmbushjen e detyrimeve nga pala tjetër dhe zhdëmtimin eventual.

Neni 16 Zgjidhja e konflikteve

Në rastet e mosmarrëveshjeve midis palëve, ato do të kenë 30 ditë afat për zgjidhjen me mirëkuptim të konfliktit. Në qoftë se brenda kësaj periudhe nuk arrijnë në një marrëveshje, palët i drejtohen gjykatës kompetente.

Neni 17 Elementë të tjerë të Kontratës

1. Kjo kontratë përmban bashkëlidhur kopje të Aneksit 1: Projekt Propozimin/ kalendarin e aktiviteteve dhe Aneksit 2: Formën e buxhetin e miratuar nga Bordi i Administrimit të AKKSHI-së.
2. Anekset janë pjesë integrale dhe detyruese e kontratës.
3. Në rast mospërputhjeje, prevalon kjo Kontratë.

Neni 18 Të ndryshme



1. Ndryshimet dhe shtesat e kësaj Kontrate bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga palët.
2. Kjo Kontratë përbën marrëveshjen e plotë të palëve dhe përcakton në mënyrë ekskluzive afatet dhe kushtet lidhur me objektin e saj.
3. Për çështje që nuk parashikohen specifikisht në këtë Kontratë, palët do t'i referohen akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Kjo Kontratë është hartuar dhe lidhur në 4 kopje origjinale në gjuhën shqipe, nga të cilat 2 (dy) i mban AKKSHI-ja dhe 2 (dy) Përfituesi.

Pasi u lexua nga palët, Kontrata nënshkruhet me vullnetin e tyre të lirë.

Kjo kontratë nënshkruhet nga:

Për AKKSHI

Znj.Z. _____
Drejtori i Përgjithshëm

Për Universitetin _____

Znj.Z. _____
Rektor

Znj.Z. _____
Kandidati doktorant



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT

KALENDAR I AKTIVITETEVE | PËR PROJEKTIN SHKENCOR TË FINANCUAR NGA AKKSHI
NË KUADËR TË PROGRAMIT KOMBËTAR TË DOKTORATËS 202__

VITI I PARË

Aktiviteti/Muaji	Produkti	Buxheti i miratuar	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor

VITI I DYTË

Aktiviteti/Muaji	Produkti	Buxheti i miratuar	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor

DREJTUESI I PROJEKTIT

UDHËHEQËSI SHKENCOR

ANEKS KONTRATË | KALENDAR I AKTIVITETEVE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PROGRAMEVE KOMBËTARE

DEKLARATË ANGAZHIMI

**NË ZBATIM TË KONTRATËS
PËR FINANCIMIN E STUDIMEVE TE DOKTORATURËS PËR VITIN _____**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 464, datë 31.07.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 607, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)", Vendimit nr.75, datë 12.2.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor" të Këshillit të Ministrave, si dhe Vendimit Nr. _____, datë _____._____.2026 "Për miratimin e financimit të Studimeve të Doktoraturës, për vitin 2026", të Bordit të Administrimit të AKKSHI – së, të Bordit të Administrimit të AKKSHI - së.

Unë i/e nënshkruar/i/a _____, me numër identifikimi _____, student/e i/e Ciklit të Tretë të Studimeve "Doktoratë" në Universitetin _____, në cilësinë e përfituesit të grantit të financimit nga AKKSHI, në kuadër të Programit Kombëtar të Doktoratës _____,

DEKLAROJ:

Në përgjegjësinë time personale se kam lexuar termat e kontratës dhe angazhohem të zbatoj të gjitha detyrimet financiare dhe jofinanciare që rrjedhin nga marrëveshja kontraktuale e financimit.

Emri, Mbiemri: _____

Data: _____._____.2026

Nënshkrimi: _____

ANEKS 2.Forma Financiare_Programi Kombëtar i Doktoratës

Përfutjesi paraqet planifikimin e detajuar të buxhetit të projektit dhe argumentim të llogaritjes së kostove

Në format nuk lejohet të shtohen apo të hiqen zëra buxhetore

Përfutjesi i financimit_Student i Doktoratës:

Udhëheqësi i doktoratës (projektit të kërkimit shkencor): Prof.

Titulli i Projektit:

Njësia Bazë

Njësia Kryesore

Nr.	Zërat e detajuar të shpenzimeve	Njësia	Sasia	Kosto për njësi në ALL	Totali	Detajimi i zërave të buxhetit (Jepni një sqarim narrativ dhe dataje konkrete të çdo zëri buxhetor)	Argumentimi i kostove të llogaritura. (Jepni një arsye të llogaritjes së kostove të vlerësuar, bazuar në kostot reale të përcaktuara në Udhëzuesin AKKSHI për Programin e Studimeve të Doktoratës)
I	Udhëtime, Akomodim dhe Dieta						
1.1	Dieta për lëvizje brenda vendit	ditë					
1.2	Akomodimi brenda vendit	për/natë					
1.3	Transporti jashtë vendbanimit brenda vendit	rugë					
1.4	Dieta për lëvizje jashtë vendit	ditë					
1.5	Akomodimi jashtë vendit	për/natë					
1.5	Transporti jashtë vendit	rugë					
	TOTALI I ZËRIT I "Udhëtime, akomodim dhe dieta"						
II	Publikime dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore						
2.1	Tarifa e publikimeve në revista të huaja shkencore të indeksuara, me faktor të lartë impakti.	për/copë					
2.2	Tarifa e publikimeve në revista shkencore brenda vendit që plotësojnë kriteret e përcaktuara në Udhëzuesin AKKSHI për Programin e Studimeve të Doktoratës	për/faqe					
2.3	Tarifa për pjesëmarrje në konferenca shkencore kombëtare	copë					
2.4	Tarifa për pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombetare	copë					
	TOTALI I ZËRIT II "Publikime dhe pjesëmarrje në konferenca shkencore"						
III	Shpenzime administrative për aktivitetet e kërkimit						
3.1	Tarifa për analiza laboratorike brenda ose jashtë vendit, të parashikuara në platformën e kërkimit që kandidati ka dorëzuar dhe i është miratuar në IAL	copë					
3.2	Tarifa për blerje të literaturës shkencore të parashikuar në platformën e kërkimit që kandidati ka dorëzuar dhe i është miratuar në IAL	copë					

3.3	Tarifa për abonime në revista shkencore/platforma digjitale/librorat digjitale për qëllimin dhe përtudhën e kryerjes së studimeve, të parashikuara në platformën e kërkimit që kandidati ka dorëzuar dhe i është miratuar në IAL	copë						
3.4	Tarifa për bleje të programeve (software) në funksion të projektit të studimeve të doktoratës, të parashikuara në platformën e kërkimit që kandidati ka dorëzuar dhe i është miratuar në IAL	copë						
TOTALI I ZËRIT III "Shpenzime administrative për aktivitetet e kërkimit"								
TOTALI I FINANCIMIT								

STUDENTI I DOKTORATËS

ADMINISTRATORI I UNIVERSITETIT

DREJTUES I ZYRËS SË FINANCËS

UDHËHEQËSI SHKENCOR

REKTORI I UNIVERSITETIT

KONTRATË

PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT TË KËRKIMIT

DHE ZHVILLIMIT

KONTRATË |

PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT TË KËRKIMIT DHE ZHVILLIMIT

AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT | AKKSHI



A series of seven handwritten signatures in blue ink are located at the bottom of the page, below the text. The signatures are stylized and vary in length and complexity, representing the signatories of the contract.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KONTRATË
PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT TË KËRKIMIT DHE ZHVILLIMIT
PËR VITIN _____**

Nr. Prot. _____,

Tiranë, më _____._____.2026

E lidhur sot, më datë _____._____.2026, ndërmjet palëve kontraktuese si më poshtë:

Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), me adresë Rruga "Naim Frashëri", Nr. 37 Tiranë, në cilësinë e **Financuesit**, përfaqësuar nga Znj/Z. _____, Drejtor i Përgjithshëm, me numër të letërnjoftimit _____.

Dhe

Universitetit _____, liçensuar me Vendimin Nr. _____, datë _____._____._____, të Këshillit të Ministrave, në cilësinë e **Përfituesit**, përfaqësuar nga rektori Znj/Z. _____, me numër të letërnjoftimit _____.

Palët në këtë kontratë bien dakord si më poshtë:

**Neni 1
Baza ligjore**

Kjo kontratë lidhet në bazë të neneve 109 -113 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 464, datë 31.07.2025 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 607, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)", Vendimit nr.75, datë 12.2.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor" të Këshillit të Ministrave, si dhe Vendimit Nr. _____, datë _____._____.2026 "Për miratimin e financimit të projekteve fituese të Programit Kombëtar të Kërkimit dhe Zhvillimit (PKKZH), për vitin 2026", të Bordit të Administrimit të AKKSHI - së.

**Neni 2
Objekti i Kontratës**

Objekti i kësaj Kontrate është financimi nga AKKSHI, në formë granti, për zbatimin e Projektit me titull: "_____ ", paraqitur nga Universiteti _____, në AKKSHI, nën programin Kombëtar të Kërkimit dhe Zhvillimit (PKKZH), me drejtues projekti Znj./Z. _____.

**Neni 3
Periudha e zbatimit**

KONTRATË |

2

PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT TË KËRKIMIT DHE ZHVILLIMIT

AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT | **AKKSHI**



1. Kjo Kontratë hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të saj nga palët dhe përfundon me realizimin e të gjitha aktiviteteve të Projektit brenda afatit të parashikuar në kalendarin e projektit (pjesë integrale e kësaj Kontrate). Kontrata përfundon me dorëzimin e raportit përfundimtar nga Përfituesi dhe pranimin e këtij raporti nga Financuesi (AKKSHI). Rezultatet konsiderohen të përmbushura vetëm pas verifikimit dhe miratimit formal nga AKKSHI.
2. Zbatimi i kontratës fillon nga data e kalimit të fondit të projektit sipas buxhetit dhe planit të financimit të miratuar me Vendim Nr. ____, datë ____.____.2026 "Për miratimin e financimit të projekteve fituese të teknologjisë dhe informacionit, për vitin 2026", të Bordit të Administrimit të AKKSHI - së, në llogarinë e Përfituesit. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Përfituesi detyrohet të dorëzojë në rrugë zyrtare kalendarin e aktiviteteve të planifikuara të projektit dhe buxhetin e miratuar nga BA.

Neni 4

Shuma dhe mënyra e financimit të Projektit

Bazuar në Vendimit Nr. ____, datë ____.____.2026 "Për miratimin e financimit të projekteve fituese të Programit Kombëtar të Kërkimit dhe Zhvillimit (PKKZH), për vitin 2026", të Bordit të Administrimit të AKKSHI - së, AKKSHI-ja do të mbështesë financiarisht zbatimin e projektit me shumën totale prej _____ (me fjalë) lekë.

Me lidhjen e kësaj kontrate, kjo shumë do të kalojë në llogarinë përfituesit duke specifikuar emërtimin e projektit.

Neni 5

Detyrimet e përfituesit

Përfituesi i grantit të financimit të projektit ka detyrimin që:

1. Të reflektojë në Projekt të gjitha ndryshimet që i janë propozuar lidhur me angazhimin e personave të përfshirë në projekt, ndryshimet në buxhet, dhe sigurimin e dokumentacionit të domosdoshëm për mbarëvejtjen e projektit.
2. Të zbatojë projektin dhe të kryejë aktivitetet e planifikuara në përputhje me buxhetin e miratuar dhe planin financiar të projektit që i bashkëlidhet kësaj kontrate.
3. Të kthejë në buxhetin e shtetit, të gjitha fondet e pashpenzuara brenda 15 ditësh pas përfundimit të projektit, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.
4. Të dorëzojë pranë AKKSHI-së raportet (e ndërmjetme dhe përfundimtare) teknike dhe financiare, shoqëruar me dokumentacionin përkatës ashtu siç është përcaktuar në nenin 6 të kësaj kontrate dhe anekset bashkëlidhur.

Neni 6

Raportimi



1. Gjatë zbatimit të projektit, përfituesi i grantit raporton lidhur me ecurinë e zbatimit të projektit, në periudhë të ndërmjetme (pas gjysmës së periudhës së projektit), pas përfundimit të projektit dhe sa herë që kjo i kërkohet nga AKKSHI për aspekte të veçanta të ecurisë së tij. Forma e raportimit përcaktohet nga AKKSHI.
2. Në përfundim të zbatimit të projektit, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune, përfituesi i grantit dorëzon në AKKSHI, në 2 (dy) kopje, raportin përfundimtar teknik të realizimit të projektit, shoqëruar me shkresë përcjellëse nga rektori i institucionit të arsimit të lartë përfitues i grantit.
3. Raporti përfundimtar hartohet sipas formatit të AKKSHI dhe duhet të përmbajë:
 - a. Raportin shkencor sipas formatit të AKKSHI dhe përcaktimeve të parashikuara në Udhëzuesin PKKZH të publikuar në faqen zyrtare të AKKSHI.
 - b. Raportin financiar sipas formatit të AKKSHI dhe përcaktimeve të parashikuara në Udhëzuesin PKKZH të publikuar në faqen zyrtare të AKKSHI.
 - c. Produktet që janë realizuar sipas planit të aktiviteteve dhe buxhetit të miratuar, të cilat mund të jenë:
 - c.1. Artikuj shkencorë të publikuar në kuadër të projektit në revista shkencore. Në këtë rast dorëzohet 1 (një) kopje e printuar e artikullit, linku i botimit online (nëse është e mundur) si dhe të dhënat e tjera të botuesit;
 - c.2. Monografi shkencore. Në këtë rast dorëzohet 1 (një) kopje e printuar e monografisë, linku i botimit online (nëse është e mundur) si dhe të dhënat e tjera të botuesit;
 - c.3. Artikuj shkencorë ose prezantime në kuadër të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare që autori ka dërguar. Në këtë rast dorëzohet 1 (një) kopje e printuar e artikullit, kopje e librit përmbledhës të abstrakteve (Abstract Book), kopje e librit përmbledhës të punimeve/prezantimeve të konferencës (Proceedings book), linku i konferencës ku janë publikuar online dokumentat e sipërcituar.
 - c.4. Konferenca/workshope/seminare/etj. shkencore të organizuara në kuadër të projektit. Në këtë rast dorëzohen: agjenda, listëprezenca, përmbledhje, prezantime, foto të aktivitetit, linku përkatës nëse zhvillohet online, materiale të prodhuara për pjesëmarrësit (fletëpalosje, postera, banera, etj), si dhe çdo produkt tjetër të prodhuar.
 - c.5. Anketime, krijim databazash, modele, katalogje, etj. Në këtë rast dorëzohen të dhënat e mbledhura me CD/USB si dhe linku online nëse janë publikuar.
 - c.6. Analiza laboratorike të kryera në kuadër të projektit. Në këtë rast dorëzohet lista e plotë dhe e detajuar e analizave që janë kryer, numri dhe lista e subjekteve që kanë shërbyer si kampion, lista e reagentëve që janë përdorur dhe rezultatet përfundimtare.
 - c.7. Çdo produkt tjetër të prodhuar në kuadër të projektit.
4. Pas dorëzimit të raportit përfundimtar final, AKKSHI kontrollon nëse raporti dhe i gjithë dokumentacioni shoqërues është hartuar sipas kritereve të kërkuara.
 - a. Në rast se raporti përfundimtar është kryer sipas kërkesave, institucioni përfitues merr konfirmimin nga AKKSHI për përmbylljen me sukses të projektit dhe shlyerjen e të gjitha detyrimeve që ka patur ndaj AKKSHI-së në kuadër të zbatimit të tij;



- b. Në rast të konstatimit të parregullsive, njoftohet përfituesi i grantit për plotësimin/korrigjimin e dokumentacionit brenda 10 (dhjetë) ditë pune;
 - c. Një përmbledhje e produktit të projektit, e përkthyer në gjuhën angleze do të përgatitet nga Përfituesi dhe të publikohet në web faqen zyrtare të IAL-së dhe AKKSHI-së;
 - d. Një video e rrugëtimit, zbatimit dhe përdorimit do të përgatitet nga Përfituesi dhe të publikohet në web faqen zyrtare të IAL-së dhe AKKSHI-së;
5. Në rastin kur institucioni përfitues i grantit shkel detyrimin lidhur me raportimet dhe realizimin e produktit/eve parashikuar në projektin e miratuar, AKKSHI kërkon auditimin e shumës së përfituar, deri në kthimin e tij në buxhetin e shtetit.

Neni 7

Të dhëna bankare të përfituesit:

- a. Emri i përfituesit të grantit: _____
- b. NIPT: _____
- c. Kodi i institucionit: _____
- d. Emri i Bankës së përfituesit : _____
- e. Numri i llogarisë bankare në lekë : _____
- f. Numri IBAN : _____
- g. Districti (TDO)/ kodi i degës së thesarit _____

Neni 8

Përgjegjësia e Përfituesit

1. Përfituesi është subjekti përgjegjës për zbatimin me efektivitet të projektit sipas Formularit të Projekt propozimit të plotë dhe formës së planifikimit financiar të projektit fitues.
2. AKKSHI-ja nuk mban asnjë përgjegjësi për dëmtime apo ankesa të shkaktuara nga dhe nëpërmjet projektit. Përfituesi mban të gjithë përgjegjësinë ndaj palëve të treta.
3. Përfituesi i grantit duhet të respektojë kërkesat e Kodit të Etikës së kërkimit shkencor, etikën e komunikimit me subjektet me të cilat bashkëpunon gjatë realizimit të projektit, si dhe detyrimet ligjore të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me pronësinë industriale.
4. Nëse gjatë realizimit të projektit, përfituesi i grantit përballet me situata që mund të çojnë realizimin e projektit sipas planifikimit, zbatimin në kohë të aktiviteteve të parashikuara në projekt ose ndërprerjen e tyre, ai njofton menjëherë AKKSHI-në, me të cilin dakordësojnë një kalendar të përditësuar të realizimit të aktiviteteve të projektit.
5. Përfituesi ka përgjegjësinë e plotë ligjore lidhur me zbatimin e procedurave financiare, të parashikuara nga kuadri ligjor përkatës në fuqi. Veprimtaria financiare e përfituesit gjatë zbatimit të projektit është subjekt i auditimit nga institucionet përkatëse audituese sipas parashikimeve ligjore në fuqi.
6. Përfituesi ka detyrimin të zbatojë kuadrin ligjor në fuqi të prokurimit publik lidhur me procedurat e prokurimit.

Neni 9



Monitorimi/Kontrolli

1. Për çështjet që i takojnë monitorimit të objektit të kësaj Kontrate, përfituesi duhet t'i përgjigjet kërkesës së financuesit për monitorim të ecurisë së projektit, brenda 10 (dhjetë) ditë pune nga marrja e kërkesës.
2. Përfituesi duhet të ofrojë akses në institucion për monitoruesit e AKKSHI-it pas njoftimit paraprak të këtyre të fundit dhe të ofrojë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar lidhur me projektin (duke përfshirë informacionin financiar). Kjo përfshin dhe nënkupton informacion mbi të gjithë projektin dhe jo vetëm mbi pjesën e financuar me fonde nga AKKSHI-ja.
3. Përfituesi detyrohet të plotësojë kërkesat sipas përcaktimeve të parashikuara në kuadrin ligjor përkatës të Projekteve të Teknologjisë dhe Inovacionit, të publikuar nga AKKSHI në faqen e saj zyrtare elektronike, dhe për të cilin Përfituesi merr njoftim edhe në rrugë elektronike pas shpalljes së Vendimit të Miratimit për Financim me Grante.
4. Përfituesi detyrohet të mbajë të gjithë dokumentacionin (duke përfshirë dokumentet financiare) lidhur me projektin të paktën 3 vjet pas përfundimit të tij. Gjithashtu, është i detyruar të ofrojë akses në këto dokumente ndaj çdo monitorimi që kryhet nga AKKSHI, apo çdo institucion tjetër që kanë kompetencë kontrollin e shpenzimeve të fondeve publike.

Neni 10

Transparenca, Publikimi dhe njohja e financimit

1. Përfituesi detyrohet të sigurojë transparencë të plotë mbi zbatimin e projektit dhe përdorimin e fondeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kërkesat e AKKSHI-së.
2. Përfituesi është i detyruar të publikojë në faqen zyrtare të institucionit dhe/ose në kanalet e tjera të komunikimit:
 - përshkrimin e projektit;
 - burimin e financimit;
 - rezultatet kryesore të arritura.
3. Në çdo material informues, shkencor apo promovues (përfshirë publikime, prezantime, konferenca, faqe interneti, raportime apo produkte të tjera të lidhura me projektin), Përfituesi detyrohet të njohë dhe të përmendë në mënyrë të qartë mbështetjen financiare të AKKSHI-së.
4. Përfituesi detyrohet të përdorë logon dhe identitetin vizual të AKKSHI-së, në përputhje me standardet dhe udhëzimet e përcaktuara nga kjo e fundit, në:
 - të gjitha materialet;
 - aktivitetet
 - produkte të përgatitura në kuadër të projektit;
 - materialet e komunikimit dhe publikimit.
5. Në çdo publikimit apo prezantimit publik të produktit të prodhuar në kuadër të projektit duhet të vendoset një mbishkrim i dukshëm me përmbajtje:
"Mundësuar me mbështetjen financiare të AKKSHI_Ministria e Arsimit".



6. Me lidhjen e kësaj kontrate, përfituesi automatikisht lejon AKKSHI-në të publikojë dhe përdorë, për qëllime informimi dhe promovimi institucional:
 - emrin e përfituesit;
 - titullin dhe përshkrimin e projektit;
 - fondin e financuar;
 - rezultatet dhe materialet përkatëse.në çdo mënyrë që Agjencia e konsideron të dobishme.
7. Përfituesi, nuk mund të krijojë të ardhura nga shitja e botimeve të financuara në kuadër të këtij projekti.
8. Në rast se projekti parashikon produkte të shkruara të destinuara për publikim, përfituesi duhet t'i dorëzojë AKKSHI-së pesë (5) kopje për secilin publikim apo material të prodhuar në kuadër të projektit. Në rast se projekti parashikon produkte për publikim online, përfituesi duhet të vërë në dispozicion të AKKSHI-së të dhënat digjitale të publikimit (web, link, ISSN, etj).
9. Mosrespektimi i detyrimeve të këtij neni përbën shkelje kontraktuale dhe mund të sjellë masa administrative dhe/ose financiare sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate.

Neni 11

Pronësia dhe autorësia e produkteve të projektit

1. Marrëdhëniet e autorësisë dhe pronësisë së projektit rregullohen sipas legjislacionit mbi të drejtën e pronësisë intelektuale.
2. Përfituesi gëzon të drejtën e autorësisë për të gjitha botimet e realizuara në kuadër të financimit të projektit.
3. Financuesi gëzon të drejtën e pronësisë intelektuale për të gjitha botimet e realizuara në kuadër të financimit të projektit.

Neni 12

Ndryshimet e Kontratës

1. Ndryshimet thelbësore në mënyrën/metodën e realizimit të projektit mund të ndodhin vetëm pas miratimit nga Bordi i Administrimit të AKKSHI, pas paraqitjes së kërkesës zyrtare nga përfituesi me argumentimin përkatës.
2. Zgjatja në kohë e projektit behet vetëm në rastet kur shfaqen problematika që nuk varen nga zbatuesi i projektit. Në çdo rast, shtyrja e projektit bëhet vetëm me miratimin e AKKSHI-së, pasi përfituesi paraqet kërkesë me argumentat përkatëse, jo me vonë se 22 ditë pune përpara përfundimit të projektit.
3. Në rast të ndryshimit të drejtuesit ose anëtarit të grupit kërkimor, përfituesi njofton me shkrim AKKSHI, ku argumenton ndryshimin dhe përcjell edhe të dhënat e personit/personave zëvendësues.
4. Rishpërndarja e fondeve buxhetore bëhet vetëm me miratimin paraprak të AKKSHI-së. Ndryshimet në buxhet lejohen deri në kufirin 10% të buxhetit parashikuar për çdo zë të projektit, duke ruajtur totalin e buxhetit sipas rubrikave. Ndryshimet buxhetore të bëra si



pasojë e rishpërndarjes duhet të reflektohen në raportin e ndërmjetëm/përfundimtar të projektit.

5. Çdo ndryshim tjetër në këtë Kontratë mund të bëhet vetëm nëpërmjet një akti shtesë të nënshkruar nga palët.

Neni 13 Ndërpreja e Kontratës

Kontrata mund të ndërpritet nëse:

1. Kjo Kontratë përfundon rregullisht sipas përcaktimit në Nenin 3 më sipër.
2. Përfituesi nuk zbaton projektin në cilësinë dhe sasinë e parashikuar në projektin objekt të kësaj Kontrate.
3. Kontrolli i Shtetit ose autoritete të tjera që sipas ligjit kanë të drejtë të kontrollojnë shpenzimet e fondeve buxhetore konstatojnë shkelje dhe kjo pranohet nga AKKSHI-ja.
4. AKKSHI mund të zgjidhë menjëherë këtë Kontratë, në rast se përfituesi shkel ndonjë prej detyrimeve të parashikuara në këtë Kontratë, apo në Legjislacionin shqiptar.
5. Ka Forca Madhore.

Neni 14 Shpenzime të lejueshme/të palejueshme

1. Të gjitha shpenzimet duhet të bëhen gjatë periudhës së zbatimit të projektit. Ato duhet të jenë reale dhe të lidhura me projektin e miratuar.
2. Shpenzimet administrative brenda miratimit të buxhetit limit, duhet të jenë të lidhura direkt me aktivitetet specifike të projektit dhe jo me funksionimin e përgjithshëm të institucionit.
3. Shpenzimet e mëposhtme nuk janë të lejueshme dhe nuk mbulohen me fondin e Grantit që financon Projektin:
 - a. Blerje e tokës;
 - b. Shit-blerje makinash;
 - c. Interes mbi huadhënie;
 - d. Marrëveshje huadhënie;
 - e. Dhurime;
 - f. Financim i partive politike apo organizatave e grupeve fetare;
 - g. Krijim i përfitimeve për anëtarët e Bordit, stafit apo të të afërmeve të tyre (përfshirë kompanitë në të cilat ato kanë interesa) nëpërmjet angazhimit në transaksione me ta apo të tjera shpërblime për pjesëmarrjen e tyre në aktivitete të projektit;
 - h. Veprime në kundërshtim me legjislacionin në fuqi;
 - i. Çdo shpenzim që nuk bën pjesë në buxhetin e miratuar nga BA, bashkëlidhur kësaj kontrate.

Neni 15 Sanksionet



1. Moszbatimi i detyrimeve për afatet e paraqitjes së raporteve financiare dhe atyre të programuara, sjell për pasojë në mënyrë të përshkallëzuar paralajmërimin e Përfituesit, ndërprerjen e financimit dhe përjashtimin nga financimi i projekteve për një periudhë 3 (tre) vjeçare.
2. Në rastin e mos përmbushjes së aktiviteteve të projektit apo kryerjes së shpenzimeve që nuk kanë qenë të lejuara, pjesa respektive e buxhetit do t'i kthehet AKKSHI-së brenda 7 (shtatë) ditëve.
3. Në rast të konstatimit të shkeljeve ligjore/etike gjatë zhvillimit të aktiviteteve të projektit, Përfituesi detyrohet t'i kthejë AKKSHI-së të gjithë shumën e grantit të financuar deri në kohën e konstatimit të kësaj shkeljeje.
4. Në rast se fondet e financuara me anë të këtij Granti, nuk janë shpenzuar sipas zërave të buxhetit të miratuar në Planin Plotë të Buxhetit që shoqëron këtë kontratë, apo konstatohen shpenzime të palejueshme sipas nenit 15 të kësaj kontrate, shuma e shpenzuar në shkelje të kontratës do t'i kthehet buxhetit të shtetit.
5. Në rast të ndërprerjes së realizimit të projektit nga ana e IAL-së Përfituese, duke mos u kufizuar vetëm në shkaqet e parashikuara në Nenin 13 të kësaj kontrate, AKKSHI i drejtohet gjykatës kompetente për rikuperimin e fondeve të lëvruara të Grantit që janë të papërdorura dhe/ose të pajustificuara me dokumentacionin ligjor përkatës për kryerjen e shpenzimeve në kuadër të Projektit, siç përmendet në Nenin 2 të kësaj kontrate.
6. Për shkeljet e përmendura në paragrafët 1-5 të këtij neni dhe kur nuk zbatohet asnjë afat i parapërcaktuar në këtë kontratë, AKKSHI-ja i drejtohet Gjykatës kompetente lidhur me mos përmbushjen e detyrimeve nga pala tjetër dhe zhdëmtimin eventual.

Neni 16 Zgjidhja e konflikteve

Në rastet e mosmarrëveshjeve midis palëve, ato do të kenë 30 ditë afat për zgjidhjen me mirëkuptim të konfliktit. Në qoftë se brenda kësaj periudhe nuk arrijnë në një marrëveshje, palët i drejtohen gjykatës kompetente.

Neni 17 Elementë të tjerë të Kontratës

1. Kjo kontratë përmban bashkëlidhur kopje të Aneksit 1: Projekt Propozimin dhe Aneksit 2: Buxhetin e miratuar nga Bordi i Administrimit të AKKSHI-së.
2. Anekset janë pjesë integrale dhe detyruese e kontratës.
3. Në rast mospërputhjeje, prevalon kjo Kontratë.

Neni 18 Të ndryshme

1. Ndryshimet dhe shtesat e kësaj Kontrate bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga palët.



2. Kjo Kontratë përbën marrëveshjen e plotë të palëve dhe përcakton në mënyrë ekskluzive afatet dhe kushtet lidhur me objektin e saj.
3. Për çështje që nuk parashikohen specifikisht në këtë Kontratë, palët do t'i referohen akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Kjo Kontratë është hartuar dhe lidhur në 4 kopje origjinale në gjuhën shqipe, nga të cilat 2 (dy) i mban AKKSHI-ja dhe 2 (dy) Përfituesi.

Pasi u lexua nga palët, Kontrata nënshkruhet me vullnetin e tyre të lirë.

Kjo kontratë nënshkruhet nga:

Për AKKSHI

Znj.Z. _____
Drejtori i Përgjithshëm

Për Universitetin _____

Znj.Z. _____
Rektor

Znj.Z. _____
Drejtuesi i projektit

ANEKS 2. Forma e Propozimit Financiar

Forma e planifikimit të detajuar të buxhetit të projektit

Aplikanti (Agjencia Ekzekutive):

Drejtes i projektit:

Titulli i Projektit:

Nr.	Zërat e detajuar të shpenzimeve	Njësia	Sasia	Kosto për njësi në lekë	Totali	Shuma e kërkuar nga AKKSHI	Shuma e mbuluar nga institucioni	Argumentimi i kostove [7]
1	Pagesë për personelin (përshirë sigurimet shoqërore dhe shëndetësore)							
1.1	Pagat për burimet njerëzore [1]							
	Drejtes i projektit	ditë pune						
	Grupi i punes [2] (detajo)							
1.2	Anetar grupi 1 (emër, mbiemër)	ditë pune						
1.3	Anetar grupi 2 (emër, mbiemër)	ditë pune						
1.4	Anetar grupi 3 (emër, mbiemër)	ditë pune						
1.5	Anetar grupi 4 (emër, mbiemër)	ditë pune						
1.6	Anetar grupi 5 (emër, mbiemër)	ditë pune						
	Stafi mbështetës administrativ dhe teknik [3] (detajo)							
1.7	Staf mbështetës 1 (emër, mbiemër)	ditë pune						
1.8	Staf mbështetës 2 (emër, mbiemër)	ditë pune						
	Totali Zëri 1							
2	Udhëtime dhe Dieta							
	Udhëtime dhe dieta [4]							
2.1	Dieta (brenda vendit)	ditë		2500				
2.2	Akomodimi (brenda vendit)	për/natë		3000				

2.3	Transport (publik për lëvizje brenda vendit)	rrugë					
Totali Zëri 2							
3	Produktet Shkencore të Projektit[5]						
3.1	Tarifa për publikimin e artikujve shkencorë (produkti i projektit) në revista shkencore të indeksuara, me faktor impakti jashtë vendit.[5.1]	për/copë					
3.2	Tarifa për publikimin e artikujve shkencorë (produkti i projektit) në revista shkencore brenda vendit. [5.2]	për/copë					
3.3	Botime shkencore si dhe pagesa për ISBN ISSN [5.3]	për/copë					
3.4	Pagesë tarifë për pjesëmarrje në konferencë shkencore jashtë vendit [5.4]	për/copë					
3.5	Pagesë tarifë për pjesëmarrje në konferencë shkencore brenda vendit [5.5]	për/copë					
3.6	Postera prezantues për arritjet e projektit	copë					
Totali Zëri 3							
4	Shpenzime administrative[6]						
4.1	Materiale për pjesëmarrësit në konferencë shkencore të realizuar për diseminimin e rezultateve të projektit. [6.1]	për/person	1000				
4.2	Kite/ reagente/ materiale të tjera konsumi në shërbim të realizimit të projektit (listë e detajuar) [6.2]	copë					
Totali Zëri 4							
TOTAL							

DREJTUESI I PROJEKTI

ADMINISTRATORI I UNIVERSITETIT

DREJTUESI I ZYRËS SË FINANCËS

DREJTUESI I AGJENCISË EKZEKUTIVESE
REKTORI I UNIVERSITETIT / DREJTORI I PËRGJITHSHËM

[1] *Pagesa e personelit të angazhuar në projekt përcaktohet në përputhje me kategorinë e vendit të punës, referuar Ldhjes nr.1 te VKM nr. 243, datë 20.4.2023, "Për një ndryshim në vendimin nr. 748, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë". Përfutjesit nga institucionet jopublike janë të detyruar të kenë të njëjtën referencë për pagesat e personelit të angazhuar në projekt.

*Zëri paga për personelin duhet të zëri jo më shumë se 70% të buxhetit të projektit të kërkuar nga AKKSHI. *Numri i ditëve të angazhimit në projekt është jo më shumë se 40 ditë /pune në 12 muaj/person. Numri maksimal i ditëve të angazhimit është 80 ditë/pune në 24 muaj/person. Periudha 6 mujore e planifikuar për publikimin e artikullit/artikujve shkencorë nuk përfshin ditë angazhimi me pagesë nga AKKSHI. Vërteimi i pagës për çdo anëtar të grupit të punës duhet i gjeneruar nga e-albania me datën më të afërt të aplikimit.

[2] Grupi i punës ndër të tjera mund të përfshijë pozicione punë: kërkues shkencorë, pedagogë, bashkëpunëtorë shkencorë, etj

[3] Staf i ndihmës është personeli që nuk kontribuon në kërkim shkencor por ka një kontribut në administrimin e aktivitetit të projektit.

[4] Aplikanti do të duhet të argumentojë udhëtimet në funksion të realizimit të aktiviteve dhe objektivave të Projektit. Gjatë implementimit të projektit, shpenzimet e udhelimit do të justifikohen me dokumentat përkatëse. Shpenzimet për transport (publik), dieta, akomodim, do të bëhen sipas VKM Nr.329, datë 20.04.2016 "Për disa ndryshime në vendimin Nr.997, datë 10.12.2010 të Këshillit të Ministrave. "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit" të ndryshuar. *Nuk lejohen udhëtimet jashtë vendit.

[5] Përfutjesi i grantit ka detyrimin: a) të vendosë logon e AKKSHI-së në të gjithë informacionin lidhur me publikimet, aktivitetet që janë mundësuar me ndihmën financiare të AKKSHI-së, si dhe mbi të gjitha materialet, aktivitetet, faqet zyrtare të internetit dhe të tjera produkte; b) të përmendë financimin AKKSHI në të gjitha artikujt/botimet e financuara në kuadër të projektit.

[5.1] Artikuj të botuar në revista ndërkombëtare të indeksuara në Scopus, me indikatorë citimi, CiteScore ose Scimago Journal Rank (SJR) dhe/ose Web of Science me indikatorë citimit të Journal Citation Report (JCR), faktor impakti IF ose Journal Citation Indicator (JCI), VKM Nr. 128, datë 6.3.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 112, datë 23.2.2018, të Këshillit të ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore 'Doktor' dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë 'Profesor' dhe 'Profesor', të ndryshuar". Një artikulli i publikuar në revistat e mësipërme është produkt i detyruar i projektit.

[5.2] Revista të kategorisë A,B,C referuar Urdhërit Nr. 36 date 24.1 2023 "Për miratimin e rregullores për krijimin e regjistrit shtetëror të revistave shkencore që botohen në Republikën e Shqipërisë",për kategoritë e revistave brenda vendit

[5.3] Monografi/libra/ revista /buletine që plotësojnë kriteret e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Monografia duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në VKM Nr. 112, datë 23.2.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i asociuar" dhe "Profesor", Kreu II, pika 5. shkronja "a".

[5.4] Prezantim në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në "Proceedings", të indeksuar me kod ISBN ose ISSN, sipas VKM Nr. 112, datë 23.2.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë "Profesor i asociuar" dhe "Profesor"

[5.5] Konferencë shkencore në përputhje me kriteret e Vendimin nr. 112, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore 'Doktor' dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë 'Profesor i asociuar' dhe 'Profesor', të ndryshuar"

[6] Në shpenzimet administrative do të futen vetëm ato shpenzime që do të përdoren për materiale për pjesëmarrësit në konferencë shkencore.

[6.1] Organizimi i konferencës shkencore për diseminimin e rezultateve të projektit është i detyruar.

[6.2] Çmimi për kite/reagente/ etj të përfshijë të gjithë koston e blerjes dhe TVSH

[7] Argumentimi i kostove është i detyrueshëm dhe duhet i detajuar për çdo zë të listuar në formën financiare.